



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 106

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 27 qershor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 29.5.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 11259
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 19.6.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 539, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, funksionimin, shpërblimin e anëtarëve të Bordit Vlerësues të Kërkesave, si dhe procedurën konkurruese për dhënien e granteve për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme”..... 11264
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 19.6.2024	Për përcaktimin e masës së përfitimit, kriterëve dhe kushteve të veçanta të përfitimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, për vitin 2024..... 11270
Udhëzim i ministrit të Drejtësisë nr. 4, datë 18.6.2024	Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën dhe afatet e dorëzimit të dokumentacionit nga përmbartuesi gjyqësor shtetëror..... 11272
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 7, datë 24.6.2024	Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në sistemin tatimor..... 11273
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 12, datë 21.6.2024	Për kriteret për pajisjen e nxënësve me dëftesë klase, dëftesë të arsimit bazë, diplomë të Maturës Shtetërore dhe certifikatë të Maturës Shtetërore 11277
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe i ministrit të Brendshëm nr. 106, datë 14.6.2024	Mbi kufizimet në qarkullimin e mjeteve të rënda për transportin rrugor të mallrave përgjatë sezonit turistik veror dhe festave..... 11280
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 110, datë 21.6.2024	Për delegimin e kompetencave..... 11283

Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 333, datë 18.6.2024	Për miratimin e Programit të Formimit Vazhdues për Përmbaruesit Gjyqësorë Shtetërorë.....	11284
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 334, datë 18.6.2024	Për miratimin e marrëveshjes tip, për mbledhjen e tarifës së suksesit nga Shërbimi Përmbarimor Shtetëror.....	11289
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 13/12, datë 24.6.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 749, datë 1.12.2022, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti ‘Ndërtimi i nënstacionit 400 kV Elbasan 3’”	11292
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 206/8, datë 24.6.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 719, datë 13.12.2023, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim, në Njësinë Administrative nr. 11, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Bashkia Tiranë”	11294
	Ndreqje gabimi në vendimin nr. 377, datë 12.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit’, të ndryshuar”, të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 102, datë 20.6.2024.....	11296



VENDIM

Nr. 329, datë 29.5.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 858, DATË 29.12.2021,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË
PROCEDURAVE E TË
DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN,
QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË
HUAJVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, pika 1, shkronja “e”, 19, pika 4, 21, pika 3, 23, pika 1, 29, pikat 1 e 6, 33, pika 6, 37, pikat 1 e 4, 56, pika 7, 81, pika 4, 84, pika 4, 91, pika 3, dhe 140, pika 1, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun II, “Kriteret dhe dokumentacioni për pajisjen me vizë”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1.1 Në ndarjen “A” bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 3 shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

“3.1 Përfshihen nga parashikimet e pikës 3 shtetasit e shtetit të Republikës Islamike të Iranit;”.

b) Shkronja “a”, e pikës 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) fëmijët nën moshën 6 vjeç;”

1.2 Në ndarjen “B” bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në pikën 4, pas fjalës “... ligjore ...” shtohen fjalët “... në gjuhën shqipe ose angleze ...”;

b) Në shkronjën “b”, të pikës 5, hiqet fjala “... i punësuar ...”.

1.3 Në ndarjen “C” bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në shkronjën “ç”, të pikës 2, pas fjalës “... dokumenti ...” shtohen fjalët “... në gjuhën shqipe ose angleze ...”;

b) Pikat 3.1, 3.2 dhe 3.3 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3.1 Dokumentacioni i përgjithshëm, si:

a) ftesa nga subjekti pritës ose anëtar i familjes së të huajt, së bashku me fotokopjen e dokumentit të identifikimit të shtetasit shqiptar ose të huajt, si dhe të lejes së tij të qëndrimit, me përjashtim të rastit kur i huaji është investitor/i vetëpunësuar/punonjës lëvizës digjital në Republikën e Shqipërisë, pensionist dhe përdorues i pasurisë së paluajtshme në Shqipëri që aplikon për vizë “D”;

b) foto pasaporte, me përmasat 47 mm x 36 mm;

c) dëshmi aftësimi profesional (diplomë/certifikatë profesionale/referenca) ose vetëdeklarim nga subjekti, ose vetëdeklarim nga i huaji në format jetëshkrimi (CV), që vërteton aftësitë/eksperiencën e mëparshme profesionale të të huajt, në lidhje me profesionin e përcaktuar në kontratën e punës, në gjuhën shqipe;

ç) vetëdeklarim për akomodim të përshtatshëm, i cili përmbush kushtet higjieno-sanitare;

d) miratim për punësim *online* nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për kategoritë që kanë detyrim për miratim paraprak, sipas ligjit për të huajt.

3.2. Dokumentacioni shtesë për vizë për motive të bashkimit familjar (D/BF), si:

a) certifikata e lëshuar jo më shumë se një muaj para aplikimit për vizë nga autoritetet përkatëse në vendin e origjinës, e cila vërteton lidhjen e personit, që kërkon bashkim familjar në Shqipëri, ose deklaratë noteriale/marrëveshje noteriale e personave bashkëjetues, ku shprehet për bashkëjetesë për më shumë se 12 muaj, shoqëruar me certifikatat personale që vërtetojnë statusin civil pa lidhje martesore të partnerëve;

b) dokumente që vërtetojnë se pritësi ka banesë të përshtatshme në Shqipëri dhe plotëson kushtet për banim (fotokopje të noterizuar të kontratës së qirasë apo të një dokumenti që tregon se ka në pronësi një banesë etj.);

c) fotokopje të noterizuar të dokumentit që vërteton se pritësi është i punësuar apo i vetëpunësuar, si dhe ka sasi të mjaftueshme të ardhurash për të siguruar jetën e



personit/personave që do të vijnë në Republikën e Shqipërisë.

3.3 Dokumentacioni shtesë për vizë për veprimtari humanitare (D/VHF), si:

a) licencë e noterizuar e ushtrimit të veprimtarive humanitare;

b) deklaratë për motivin e punës nga organizata humanitare.”.

c) Në pikën 3.4 bëhen këto ndryshime:

i. Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Nota verbale nga Misioni Diplomatik i akredituar në Republikën e Shqipërisë”;

ii. Shkronja “b” shfuqizohet;

ç) Në pikën 3.10, fjalët “... si punëmarrës (D/PM) ...” hiqen;

d) Pas pikës 3.10 shtohet pika 3.10/1, me këtë përmbajtje:

“3.10/1. Dokumentacioni shtesë për vizë tipi “D” si punëmarrës (D/PM), si:

a) Kontratë ose marrëveshje mes subjektit dhe agjencisë së licencuar në rastet kur përzgjedhja e kandidateve është bërë nga një agjenci e licencuar, e cila duhet të përmbushë kushtin e pajisjes me licencë të kategorisë X.2.A., e cila depozitohet edhe në AKPA.”.

dh) Në pikën 3.11 bëhen këto ndryshime:

i. Shkronjat “a” dhe “c” shfuqizohen;

ii. Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Miratim për punësim *online* nga AKPA-ja;”;

e) Shkronja “a”, e pikës 3.13, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Miratim për punësim *online* nga AKPA-ja;”;

ë) Shkronja “a”, e pikës 3.14, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Miratim për punësim *online* nga AKPA-ja;”;

f) Shkronja “b”, e pikës 3.15, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Miratim për punësim *online* nga AKPA-ja;”;

g) Pas shkronjës “b”, të pikës 3.16, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) Procesverbali i Komisionit Vlerësues për plotësimin e kushteve të lejes unike si i vetëpunësuar.”;

gj) Shkronja “a”, e pikës 3.18, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Procesverbali i Komisionit Vlerësues për plotësimin e kushteve të lejes unike si investitor.”.

2. Në kreun III, “Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pajisjen me leje qëndrimi”, bëhen këto ndryshime:

2.1 Në ndarjen “B” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Fjalja hyrëse ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për t’u pajisur me leje qëndrimi, i huaji ose punëdhënësi i tij depoziton *online*, nëpërmjet platformës “*e-Albania*”, këto dokumente:”;

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Vetëdeklarim për akomodim të përshtatshëm i cili përmbush kushtet higjieno-sanitare.”.

2.2 Në ndarjen “Ç” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Aplikimi për leje unike bëhet nga vetë i huaji ose nga punëdhënësi i tij përmes portalit “*e-Albania*”, *online*, pas kryerjes së pagesës, e cila është e pakthyeshme. Në momentin e përfundimit të aplikimit, të huajt ose punëdhënësit të tij i dërgohet një njoftim në adresën elektronike që është deklaruar gjatë aplikimit, për kryerjen me sukses të aplikimit, duke gjeneruar dhe një numër gjurmimi.”;

b) Pika 2 shfuqizohet;

c) Në pikën 9, fjalët “... miratimi apo refuzimi i kërkesës i njoftohet *online* ...” zëvendësohen me “... miratimi apo refuzimi i kërkesës i njoftohet në adresën e *email*-it të deklaruar gjatë aplikimit ...”.

2.3 Në ndarjen “D”, shkronjat “a” dhe “b” ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) Dokumentacioni shtesë për leje unike si punëmarrës:

i. Kontrata e punës si punëmarrës me një punëdhënësi në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, në gjuhën shqipe;

ii. Dëshmi aftësimi profesional (diploma/certifikatë profesionale /referenca) ose vetëdeklarim nga subjekti, ose vetëdeklarim nga i huaji në format jetëshkrimi (CV), që vërteton aftësitë/eksperiencën e mëparshme profesionale të të huajt, në lidhje me profesionin e përcaktuar në kontratën e punës, në gjuhën shqipe.

b) Dokumentacioni shtesë për leje unike si punëtor stinor:

i. Kontrata e punës si punëmarrës me një punëdhënësi në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, në gjuhën shqipe.”.

3. Aneksi nr. 4, “Lista e vendeve, shtetasit e të cilave hyjnë me vizë në Republikën e Shqipërisë



dhe përfaqësitë ku mund të bëhet aplikimi, si dhe tarifa përkatëse e shërbimit me vizë”, zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër dhe titull, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Në aneksin nr. 8 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në seksionin A, pika 1, nënpika 1.4, bëhen këto ndryshime:

i. Titulli “Banesa” zëvendësohet me “Vetëdeklarim për akomodim”;

ii. Fjalja “Unë kam bashkëngjitur kontratën e qirasë/dëshminë e pronësisë së bashku me aplikimin/çdo dokument tjetër që provon akomodimin” zëvendësohet me “Unë vetëdeklaroj që kam akomodim të përshtatshëm i cili përmbush kushtet higjieno-sanitare.”;

b) Në seksionin D, togfjalëshi “Person i autorizuar” hiqet.

5. Në aneksin nr. 9 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

5.1 Në seksionin A, pika 2, nënpika 2.3, bëhen këto ndryshime:

a) Në emërtesën “Bashkimi familjar” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. Titulli “Banesa” zëvendësohet me “Vetëdeklarim për akomodim”;

ii. Fjalja “Unë kam bashkëngjitur kontratën e qirasë/dëshminë e pronësisë së bashku me aplikimin/çdo dokument tjetër që provon akomodimin” zëvendësohet me “Unë vetëdeklaroj që kam akomodim të përshtatshëm i cili përmbush kushtet higjieno-sanitare.”;

b) Në emërtesën “Për motive arsimi, trajnimi dhe kërkimi shkencor” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. Titulli “Banesa” zëvendësohet me “Vetëdeklarim për akomodim”;

ii. Fjalja “Unë kam bashkëngjitur kontratën e qirasë/dëshminë e pronësisë së bashku me aplikimin/çdo dokument tjetër që provon akomodimin” zëvendësohet me “Unë vetëdeklaroj që kam akomodim të përshtatshëm i cili përmbush kushtet higjieno-sanitare.”;

c) Në emërtesën “Për arsye humanitare” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. Titulli “Banesa” zëvendësohet me “Vetëdeklarim për akomodim”;

ii. Fjalja “Unë kam bashkëngjitur kontratën e qirasë/dëshminë e pronësisë së bashku me aplikimin/çdo dokument tjetër që provon akomodimin” zëvendësohet me “Unë vetëdeklaroj që kam akomodim të përshtatshëm i cili përmbush kushtet higjieno-sanitare.”;

ç) Në emërtesën “Për qëndrim të përhershëm” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. Titulli “Banesa” zëvendësohet me “Vetëdeklarim për akomodim”;

ii. Fjalja “Unë kam bashkëngjitur kontratën e qirasë/dëshminë e pronësisë së bashku me aplikimin/çdo dokument tjetër që provon akomodimin”, zëvendësohet me “Unë vetëdeklaroj që kam akomodim të përshtatshëm i cili përmbush kushtet higjieno-sanitare.”;

d) Në seksionin D, togfjalëshi “Person i autorizuar” hiqet;

dh) Në emërtesën “Leje qëndrimi për motive të tjera” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. Titulli “Banesa” zëvendësohet me “Vetëdeklarim për akomodim”;

ii. Fjalja “Unë kam bashkëngjitur kontratën e qirasë/dëshminë e pronësisë së bashku me aplikimin/çdo dokument tjetër që provon akomodimin” zëvendësohet me “Unë vetëdeklaroj që kam akomodim të përshtatshëm i cili përmbush kushtet higjieno-sanitare.”.

II. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



ANEKS NR. 4

Lista e vendeve, shtetasit e të cilëve hyjnë me vizë në Republikën e Shqipërisë dhe përfaqësitë ku mund të bëhet aplikimi, si dhe tarifa përkatëse e shërbimit me vizë

Nr.	SHTETET QË HYJNË ME VIZË		VIZA “C”/ “A”			VIZA “D”
	Shteti	Përfaqësia ku mund të aplikohet	Kosto 1-hyrje	Kosto 2-hyrje	Kosto shumë hyrje	Kosto
1	Afganistan	Ankara, Stamboll	4566.60	4566.60	4566.60	4566.60
2	Afrika e Jugut	Romë, Londër	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
3	Algjeria	Paris	gratis	gratis	gratis	gratis
4	Angola	Romë	5074.00	7611.00	10148.00	10148.00
5	Antigua dhe Barbuda	Londër				3551.80
6	Arabi Saudite	Riad	5479.92	5479.92	5479.92	5479.92
7	Armenia	Ankara, Moskë				4059.20
8	Azerbajxhan	Ankara, Moskë				4059.20
9	Bahamas	Londër				3551.80
10	Bahrein	Riad, Doha	6088.80	6088.80	6088.80	6088.80
11	Bangladesh	Pekin	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
12	Barbados	Londër				2537.00
13	Belize	Londër	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
14	Benin	Paris	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
15	Bjellorusi	Moskë, Varshavë				10148.00
16	Bolivi	Brazilia	3044.40	3044.40	5074.00	5074.00
17	Botsvanë	Paris	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
18	Bregu i Fildishtë	Londër	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
19	Brunei	Romë, Riad				2537.00
20	Burkina Faso	Romë	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
21	Egjypt	Kajro	3551.80	3551.80	3551.80	3551.80
22	Ekuador	Brazilia	1014.80	1014.80	1014.80	1014.80
23	Emiratet e Bashkuara Arabe	Abu Dhabi				2537.00
24	Eritre	Kajro	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
25	Etiopi	Kajro	3044.40	3044.40	3044.40	3044.40
26	Filipine	Pekin	3044.40	3044.40	3044.40	3044.40
27	Gabon	Kajro, Romë	3044.40	3044.40	3044.40	3044.40
28	Gana	Kajro, Romë	3044.40	3044.40	3044.40	3044.40
29	Guajanë	Brazilia, Romë				3044.40
30	Guatemalë	Brazilia				2537.00
31	Guineja	Kajro, Stamboll	3044.40	3044.40	3044.40	3044.40
32	Gjeorgji	Ankara, Stamboll				4059.20
33	Haiti	Brazilia, Nju-Jork	3044.40	3044.40	3044.40	3044.40
34	Honduras	Brazilia, Nju-Jork				3044.40
35	Hong Kong, Kinë	Pekin				3551.80
36	Indi	Pekin, Abu Dhabi, Stamboll	1522.20	1522.20	1522.20	1522.20
37	Indonezi	Pekin	3348.84	3348.84	3348.84	3348.84
38	Irak	Ankara, Stamboll	7205.08	7205.08	7205.08	7205.08
39	Iran	Ankara, Stamboll	3551.80	3551.80	3551.80	3551.80
40	Ishujt Fixhi	Londër, Tokio	2029.60	2029.60	2029.60	2029.60
41	Jemen	Riad, Abu Dhabi	2029.60	7103.60	7103.60	7103.60
42	Jordani	Kajro	2334.04	2334.04	2334.04	2334.04
43	Kamboxhia	Pekin	4059.20	4059.20	4059.20	4059.20
44	Kamerun	Kajro	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
45	Katar	Doha	2029.60	4059.20	4059.20	4059.20
46	Kazakistan	Ankara, Moskë				10148.00
47	Kenia	Kajro	3551.80	3551.80	3551.80	3551.80



48	Republika Popullore e Kinës	Pekin				Gratis
49	Kirgistan	Ankara, Moskë	4059.20	4059.20	4059.20	4059.20
50	Kolumbi	Brazilia				4566.60
51	Kongo	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
52	Kore, Republika Popullore	Pekin, Sofje	1014.80	1014.80	1014.80	1014.80
53	Kosta Rika	Brazilia				3044.40
54	Kubë	Brazilia, Sofje	3044.40	3044.40	6596.20	6596.20
55	Kuvajt	Kuvajt				2537.00
56	Lesoto	Kajro, Stamboll	2029.60	2029.60	2029.60	2029.60
57	Libani	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	5074.00	5074.00
58	Liberi	Bukuresht	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
59	Libi	Kajro, Stamboll	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
60	Madagaskar	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
61	Makao, Kinë	Pekin				3551.80
62	Malavi	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
63	Maldives	Londër	3044.40	3044.40	3044.40	3044.40
64	Mali	Romë	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
65	Marok	Bukuresht, Paris	1116.28	1116.28	1116.28	1116.28
66	Mauritani	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
67	Mauritius	Londër				2537.00
68	Meksikë	Romë				3044.40
69	Moldavi	Bukuresht, Sofje, Ankara, Stamboll				10148.00
70	Mongoli	Moskë, Pekin	3044.40	3044.40	3044.40	3044.40
71	Mozambik	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
72	Namibi	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
73	Nepal	Pekin	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
74	Nigeri	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
75	Nikaragua	Romë				3044.40
76	Oman	Riad, Abu Dhabi	3044.40	3044.40	3044.40	3044.40
77	Pakistan	Kajro, Stamboll	2029.60	3551.80	3551.80	3551.80
78	Palestinë	Ankara, Kajro, Stamboll				
79	Panama	Romë				10148.00
80	Paraguai	Brazilia				5074.00
81	Peru	Brazilia, Madrid				6088.80
82	Republika Domenikane	Brazilia, Nju-Jork	4059.20	5074.00	7103.60	7103.60
83	Ruanda	Kajro, Stamboll	3551.80	3551.80	3551.80	3551.80
84	Rusi	Moskë	3044.40	5074.00	5074.00	5074.00
85	Salvador	Londër				2029.60
86	Sao Tome dhePrincipe	Londër	2029.60	2029.60	2029.60	2029.60
87	Senegal	Kajro, Stamboll, Paris	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
88	Seychelles	Kajro				3551.80
89	Sierra Leone	Kajro, Stamboll	3551.80	3551.80	3551.80	3551.80
90	Siri	Kajro, Stamboll	4059.20	4059.20	4059.20	4059.20
91	Somali	Kajro, Riad	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
92	Sri Lanka	Pekin	608.88	1014.80	1014.80	1014.80
93	Sudan	Kajro	6291.76	6291.76	6291.76	6291.76
94	Suriname	Brazilia	2029.60	2029.60	2029.60	2029.60
95	St. Kitts and Nevis	Tokio, Londër				3551.80
96	Tailandë	Pekin	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
97	Tanzani	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
98	Taxhikistan	Ankara, Moskë	4059.20	4059.20	4059.20	4059.20



99	Togo	Kajro, Stamboll	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
100	Trinidad dhe Tabako	Londër				2029.60
101	Tunizi	Kajro, Stamboll	1116.28	1116.28	1116.28	1116.28
102	Turkmenistan	Ankara, Stamboll, Moskë	3044.40	5074.00	6088.80	6088.80
103	Turqi	Ankara, Stamboll				3551.80
104	Ugandë	Kajro, Stamboll	2537.00	2537.00	2537.00	2537.00
105	Ukrainë	Varshavë, Shkup	8600	8600	8600	8600
106	Uruguai	Brazilia, Romë				3044.40
107	Uzbekistan	Stamboll, Moskë	3044.40	5074.00	10148.00	10148.00
108	Venezuelë	Brazilia, Romë				3044.40
109	Vietnam	Pekin	4059.20	4059.20	4059.20	4059.20
110	Xhamajkë	Londër, Nju-Jork	4059.20	4059.20	4059.20	4059.20
111	Zambia	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
112	Zimbabve	Kajro, Stamboll	2537.00	4059.20	8118.40	8118.40
113	Të tjera	Në Amb. RSH më të afërt	Në mungesë të reciprocitetit 35 eu.	Në mungesë të reciprocitetit 35 eu.	Në mungesë të reciprocitetit 35 eu.	Në mungesë të reciprocitetit 35 eu.

VENDIM**Nr. 407, datë 19.6.2024**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 539, DATË 29.7.2022,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KRIJIMIN, FUNKSIONIMIN,
SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË
BORDIT VLERËSUES TË KËRKESAVE,
SI DHE PROCEDURËN KONKURRUESE
PËR DHËNIEN E GRANTEVE PËR
NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA
DHE TË MESME”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 539, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

I. Në kreun II bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Bordi kryesohet nga drejtori ekzekutiv i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (në vijim “AIDA”) dhe ka në përbërje të tij 4 (katër) anëtarë, si vijon:

a) 2 (dy) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për ekonominë, kulturën dhe inovacionin;

b) 2 (dy) përfaqësues nga AIDA, përgjegjës për biznesin.”.

2. Në pikën 4 bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Anëtarët e Bordit, të përzgjedhur, sipas përcaktimit të dhënë në shkronjën “a”, të pikës 3, të këtij vendimi, caktohen nga ministri përgjegjës për çështjet e ekonomisë”.

b) Shkronja “c” shfuqizohet.

3. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Mbledhjet e Bordit janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se 4 (katër) anëtarë. Bordi merr vendime me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm. Anëtarët e Bordit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për konfliktin e interesit, nuk marrin pjesë në proceset përzgjedhëse dhe vendimmarrëse, kur kanë dyshime për ekzistencën e konfliktit të interesit.”.

4. Shkronja “b”, e pikës 9, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Kërkon informacione shtesë nga aplikantët nëpërmjet Njesisë për Menaxhimin e Grantit, atëherë kur gjykohet e domosdoshme për vendimmarrjen.”.

II. Në kreun III, “Procedura konkurruese” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave, për përcaktimin e masës, kriterëve dhe kushteve të përfitimit nga NMVM-të, AIDA i propozon ministrit përgjegjës për ekonominë shpalljen e thirrjes për kërkesa për grant, të



shoqëruar me vendimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore, për ndërmarrjet që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas pikës 5, të nenit 11, të ligjit nr. 43/2022. Pas miratimit, nga ministri përgjegjës për ekonominë, AIDA hap thirrjen për kërkesa nga ndërmarrjet.”.

2. Fjalja e parë e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Dorëzimi i kërkesave nga ndërmarrjet bëhet vetëm nëpërmjet adresës elektronike të AIDA-s: ndermarrje@aida.gov.al.”.

3. Pika 3 shfuqizohet.

4. Pikat 4, 5 dhe 6 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“4. Thirrja qëndron e hapur jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga dita e publikimit të saj. Pas përfundimit të afatit të thirrjes, Njësia për Menaxhimin e Grantit në AIDA, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga e nesërmbja e ditës së përfundimit të afatit të thirrjes, merr në dorëzim kërkesat dhe verifikon përmbushjen e kriterëve formale nga ana e NMVM-ve.

5. Pas verifikimit të kriterëve formale, Njësia për Menaxhimin e Grantit në AIDA i përcjell Bordit listën e kërkesave që kanë përmbushur kriteret formale dhe propozimet për NMVM-të me mangësi në dokumentacion, që nuk kualifikohen. Këto kërkesa i nënshtrohen procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga ana e Bordit, i cili mbledhet brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga dita e njoftimit.

6. Bordi vlerëson kërkesat e propozuara nga Njësia për Menaxhimin e Grantit në AIDA, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e mbledhjes së tij. Vendimi për caktimin paraprak të ndërmarrjeve fituese merret me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm në mbledhjen e Bordit.”.

5. Fjalja e fundit, e pikës 7, hiqet.

6. Pikat 8, 9 dhe 10 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“8. Ndërmarrja, së cilës i është refuzuar kërkesa, ka të drejtë ankimi, duke kërkuar raportin e vlerësimit nga Bordi dhe pikët e grumbulluara, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga dita e marrjes së njoftimit. Në raste të tilla, Bordi kthen përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga depozitimi i kërkesës me shkrim të ndërmarrjes. Lista përfundimtare e ndërmarrjeve fituese publikohet në faqen zyrtare të AIDA-s dhe

ministrisë përgjegjëse për ekonominë pas përfundimit të afatit të shqyrtimit të ankesave.

9. Brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit zyrtar, ndërmarrja e shpallur fituese me vendim Bordi nënshkruan marrëveshjen për dhënien e grantit me AIDA-n, në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të palëve.

10. Pagesa e fondit bëhet me dy këste dhe në përqindje të barabarta, një parapagim prej 50% të vlerës së fondit të përfituar dhe kësti i dytë prej 50% të vlerës së mbetur të fondit do të disbursohet pas zbatimit të projektit, kundrejt dorëzimit të dokumentacionit dhe faturës/faturave që vërteton/vërtetojnë shpenzimet e kryera. Kësti i parë kalon në llogarinë bankare të ndërmarrjes fituese brenda 5 (pesë) ditëve nga data e lidhjes së marrëveshjes. Bordi merr vendim për t'i paguar këstin e fundit ndërmarrjes fituese, vetëm pas verifikimit të dokumentacionit financiar të dorëzuar dhe vlerësimit pozitiv të raportit përfundimtar të monitorimit nga njësia përgjegjëse.”.

7. Pika 11 shfuqizohet.

8. Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Me nënshkrimin e marrëveshjes së grantit, ndërmarrja përfituese ka detyrimin të përmbushë tërësisht dhe në afat projektin e miratuar. Nëse për arsye objektive ndërmarrja nuk vijon me realizimin e projektit pas nënshkrimit të kontratës, ajo i paraqet paraprakisht AIDA-s një kërkesë për zgjidhjen e kontratës dhe kthimin e shumave, në rast se janë bërë pagesa. Kërkesa duhet të jetë e argumentuar dhe të përmbajë shkakun për të cilin është kërkuar zgjidhja e kontratës.”.

9. Pika 15 shfuqizohet.

III. Në rregulloren “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kryerjen e monitorimit, raportimit, dhe dokumentacionin e nevojshëm për t'u paraqitur nga ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme që aplikojnë për masa mbështetëse”, bashkëlidhur vendimit, bëhen shtesat dhe ndryshimet, sipas aneksit 1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



ANEKSI 1/1

1. Pas pjesës “Përmbajtja” shtohet pjesa “Përkufizime”, me këtë përmbajtje:

“Përkufizime:

1. Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “AIDA” është Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve;

b) “Bordi Vlerësues i Kërkesave” është organi kolegjial që shqyrton dhe vlerëson të gjitha aplikimet që kanë përmbushur kriteret formale;

c) “Njësia për Menaxhimin e Grantit” është sekretariatit teknik i Bordit, i cili merr në dorëzim dhe shqyrtim çdo aplikim të paraqitur, i cili plotëson kriteret e kësaj rregulloreje.

ç) “Ndërmarrje” është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në regjistrin tregtar, i cili ushtron veprimtari ekonomike;

d) “NMVM” janë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, që janë regjistruar në regjistrin tregtar, në të cilat me përjashtim të rasteve të përcaktuara në pikën 7, të këtij neni, organet publike, direkt ose indirekt, nuk mund të zotërojnë më shumë se 25% të kapitalit apo të të drejtave të votës.

dh) “Ndërmarrje të reja” janë ndërmarrjet mikro, të vogla e të mesme, të cilat janë regjistruar në regjistrin tregtar prej jo më shumë se 12 muajsh;

e) “Kërkues” është personi fizik/juridik me seli në territorin e Republikës të Shqipërisë, i cili kërkon mbështetje financiare nga buxheti i shtetit;

ë) “Kërkesa” është kërkesa për përfitim granti pasqyruar në formularin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës, që paraqitet nga kërkuesi në AIDA;

f) “Grant” është mbështetje financiare nga buxheti i shtetit;

g) “Kritere” janë kushtet dhe kërkesat për ndërmarrjet për dhënien e granteve.

2. Termat e përdorur në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjet nr. 10 303, datë 15.7.2010, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)”, dhe nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.”.

2. Pika 1 “Hyrje”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë në mënyrë të detajuar rregullat, kriteret, procedurën e aplikimit, disbursimit dhe monitorimit të projekteve fituese për mbështetje me grant për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, në zbatim të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.”.

7. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Procedura e aplikimit është, si më poshtë:

a) Kërkuesi për mbështetje me fond dërgon kërkesën në rrugë elektronike në adresën e AIDA-s: ndermarrje@aida.gov.al.

b) Dërgimi i kërkesave në rrugë elektronike do të konfirmohet nga AIDA me një përgjigje me *e-mail* dhe do të protokollohen me datën e mbërritjes në adresën: ndermarrje@aida.gov.al.

c) Formulari i kërkesës dhe dokumentacioni i dërguar në rrugë elektronike duhet të jenë në formatin PDF.

ç) Thirrja qëndron e hapur jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga dita e publikimit të saj. Njoftimi për thirrje do të publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit: www.meki.al dhe të AIDA-s: www.aida.gov.al dhe në rrjetet sociale të AIDA-s.

d) Formulari i kërkesës, buxhetit dhe deklarata për kategorinë e NMVM-ve do të shkarkohen në linkun që do të vihet në dispozicion nga AIDA.”.

8. Pas pikës 5 shtohet pika 5.1, me këtë përmbajtje:

“5.1. Shqyrtimi i kërkesave:

a) Njësia për Menaxhimin e Grantit në AIDA, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga e nesërmja e datës së përfundimit të afatit të thirrjes, merr në shqyrtim çdo kërkesë të paraqitur dhe verifikon përmbushjen e kërkesave formale nga ana e NMVM-ve.

b) Pas vlerësimit të kërkesave formale nga Njësia për Menaxhimin e Grantit në AIDA, kjo e fundit i përcjell Bordit listën e kërkesave që kanë përmbushur kriteret formale dhe propozimet për NMVM-të me mangësi në dokumentacion që nuk kualifikohen. Këto kërkesa i nënshtrohen procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga ana e Bordit, i cili mbledhet brenda 5 ditëve kalendarike nga dita e njoftimit.

c) Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e mbledhjes së tij, Bordi vlerëson aplikimet e propozuara nga Njësia për Menaxhimin e Grantit në AIDA. Në përfundim të procesit të shqyrtimit,



Bordi plotëson formularin e vlerësimit për çdo aplikim, duke marrë vendimin për caktimin e fituesve paraprakë dhe përcakton nivelin e grantit për secilin përfitues.

ç) Miratimi i dhënies së grantit merret me vendim të Bordit, bazuar në pikën 4, të nenit 11 të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”. Vendimi për përfituesit e ndërmarrjeve, merret me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm në mbledhjen e Bordit.

d) Brenda 3 (ditëve) kalendarike nga vendimmarrja paraprake të Bordit, AIDA, njofton me *e-mail* përmes adresës elektronike ndermarrje@aida.gov.al ndërmarrjet e interesuara, nëse:

i. kërkesa është refuzuar nga Bordi, duke dhënë arsytet e refuzimit;

ii. kërkesa është miratuar nga Bordi.

dh) Ndërmarrjes, së cilës i është refuzuar kërkesa, ka të drejtë ankimi, duke kërkuar raportin e vlerësimit nga Bordi dhe pikët e grumbulluara, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga dita e marrjes së njoftimit. Në raste të tilla, Bordi kthen përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga depozitimi i kërkesës me shkrim të ndërmarrjes. Lista përfundimtare e ndërmarrjeve fituese shpallet pas përfundimit të afatit të shqyrtimit të ankesave.”.

9. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Shpallja e projekteve do të bëhet si vijon:

a) Lista e ndërmarrjeve fituese publikohet në faqen elektronike të AIDA-s dhe të ministrisë përgjegjëse për ekonominë.

b) Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit zyrtar, ndërmarrja e shpallur fituese, nënshkruan marrëveshjen për dhënien e grantit me AIDA. Me nënshkrimin e marrëveshjes së grantit, ndërmarrja fituese ka detyrimin të përmbushë tërësisht dhe në afat projektin e miratuar. Nëse për arsye objektive ndërmarrja nuk vijon me realizimin e projektit pas nënshkrimit të kontratës, ajo i paraqet paraprakisht AIDA-s një kërkesë për zgjidhjen e kontratës dhe kthimin e shumave në rast se janë bërë pagesa. Kërkesa duhet të jetë e argumentuar dhe të përmbajë shkakun për të cilin është kërkuar zgjidhja e kontratës.

c) Projektet e shpallura fituese fillojnë zbatimin e tyre nga data e nënshkrimit të marrëveshjes së fitimit të grantit e deri në afatin e deklaruar në planin e biznesit.

Afati përfundimtar për dorëzimin e të gjithë dokumentacionit administrativ dhe financiar do të jetë jo më vonë se muaji nëntor i vitit përkatës.”.

11. Në pikën 8, togfjalëshi “Njësia monitoruese” zëvendësohet me “Njësia për Menaxhimin e Grantit”.

12. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Kriteret vlerësuese;

a) Kërkesat i nënshtrohen procesit të vlerësimit nga ana e Bordit, i cili i vlerëson ato mbi bazën e pikëzimit të përcaktuar, si më poshtë.

Kriteret	Pikët
Përputhshmëria e modelit të biznesit me kriteret e thirrjes së fondit	20 pikë
Burime njerëzore dhe kapaciteti financiar për zbatimin e projektit të propozuar	10 pikë
Qartësia e përshkrimit të aktiviteteve që do të realizohen	20 pikë
Qartësia e përshkrimit të impaktit dhe e rezultateve të matshme	10 pikë
Aktivitetet e ndërmarrjes rrisin numrin e të punësuarve	10 pikë
Aplikuesi është femër	10 pikë
Aktivitetet e ndërmarrjes kanë impakt pozitiv mjedisor	10 pikë
Aktivitetet e ndërmarrjes janë inovative	10 pikë
TOTALI	100pikë

b) Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme fituese do të shpallen sipas renditjes së pikëve të mbledhura në raport me grantin total në dispozicion.”.

13. Pika 10 shfuqizohet.

14. Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Njësia për Menaxhimin e Grantit krijohet

me urdhër të drejtorit ekzekutiv të AIDA-s dhe ushtron detyrat administrative, si më poshtë:

a) Promovon skemën e mbështetjes me grant dhe realizon fushatën e ndërgjegjësimit të NMVM-ve për aplikim.

b) Merr në dorëzim, shqyrton dhe vlerëson përmbushjen e kriterëve formale të ndërmarrjeve



që kanë aplikuar për përfitim granti.

c) Mban komunikimin e vazhdueshëm me subjektet aplikuese mbi ecurinë e procesit.

ç) I përcjell Bordit rezultatin e vlerësimit të kërkesave formale dhe dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtim të mëtejshëm.

d) Merr pjesë në mbledhjet e Bordit pa të drejtë vote dhe referon projektet aplikuese, si dhe mban procesverbalin përkatës të mbledhjes, i cili i paraqitet për shqyrtim dhe nënshkrim;

dh) Merr në dorëzim raportet përfundimtare të paraqitura nga përfituesit e granteve dhe kërkon

informacione sqaruese mbi dokumentacionin e dorëzuar, sa herë që e gjykon të nevojshme;

e) Harton raportin final të grantit në fund të vitit kalendarik dhe e paraqet pranë ministrit përgjegjës për ekonominë. Raporti final i grantit duhet të përmbajë ecurinë dhe impaktin e grantit gjatë gjithë vitit kalendarik, aplikuesit dhe fituesit, si dhe një analizë mbi problematikat e hasura dhe impaktin e fondit.”.

15. Formulari i kërkesës dhe formulari i buxhetit ndryshojnë, si më poshtë vijon:

**“FORMULARI I KËRKESËS
PËR MBËSHTETJEN ME GRANT TË NDËRMARRJEVE MIKRO, TË VOGLA
DHE TË MESME**

I. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Titulli i projektit	
Skema/masa ku kërkon	
Kategoria e ndërmarrjes	☐ mikro ☐ vogël ☐ mesme
Sektori në të cilin bën pjesë	
Emri i kërkuarit	
Statusi ligjor	☐ Person fizik ☐ Person juridik
Përfaqësuesi ligjor	NIPT (numri unik i identifikimit të subjektit):
Numri personal i identifikimit	Emër Mbiemër
I kthyer nga emigrimi	(ID i përfaqësuesit ligjor)
Adresa	☐ Po ☐ Jo
E-mail	
Website	
Numri i telefonit	(prefiksi + numri)
Kohëzgjatja e projektit	(periudha minimale-maksimale/ muaj)
Vendi/et ku zbatohet projekti	
Buxheti total i projektit	(vlera në lekë)

II. PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT

Qëllimi i projektit: (Përshkruani shkurtimisht projektin, duke adresuar direkt problematikën dhe argumentimin sesi projekti iu përgjigjet nevojave të identifikuara (max 1500 karaktere).)

1. Objektivat e projektit (maksimumi 5 rreshta për secilin objektiv).

2. Përshkrimi i modelit të biznesit të aplikantit (Jepni një përshkrim të shkurtër të fushës dhe historikut së aktivitetit (max 250 karaktere).)

3. Përfituesit dhe rezultatet (Cilët janë përfituesit dhe rezultatet finale të aktivitetit tuaj?)

4. Qëndrueshmëria (Përshkruani qëndrueshmërinë e projektit në terma afatmesëm dhe afatgjatë. A planifikoni zgjerimin e biznesit jashtë territorit shqiptar? (max 250 karakter).)

5. Përshkrimi i aktiviteteve (Shpjegoni aktivitetet e parashikuara të projektit, për të cilat kërkonit financim, duke përcaktuar edhe kohëzgjatjen e secilit.)

6. Rezultatet e pritshme të projektit (Përshkruani rezultatet e pritshme të aktiviteteve, për secilin prej tyre.)

7. Përshkrim i burimeve njerëzore (Jepni informacion lidhur me numrin total të të punësuarve dhe të numrit të personave që do të punësohen gjatë apo pas zbatimit të projektit, duke përshkruar edhe



pozicionin dhe detyrat e secilit.)

8. Performanca e aktivitetit ndër vite (Plotësoni tabelën e mëposhtme mbi treguesit kryesorë financiarë në 2 (dy) vitet e fundit.)

Bilanci	Viti	Viti
Të ardhurat		
Fitimi neto		

9. Financime të mëparshme nga grante dhe skema të ndryshme (Listoni financimet nga donatorë të tjerë (publikë dhe/ose privatë) gjatë 3 viteve të fundit, duke përshkruar shkurtimisht projektin e mbështetur, donatorin, vlerën e financimit të përfituar, dhe periudhën e zbatimit.)

Emri i aplikuesit (përfaqësuesi ligjor): _____

Vendi dhe data: _____, _____

Nënshkrimi dhe vula (nëse ka): _____.”.

“FORMATI I BUXHETIT

Emri i aplikuesit: _____

Titulli i projektit: _____

Koha e zbatimit: nga/deri : _____

Nr.	Lloji i shpenzimit	Njësia	Sasia	Çmimi në lekë	Totali (pa TVSH)
1					
2					
3					
4					
5					
	Total pa TVSH				-

Emri i aplikuesit (përfaqësuesi ligjor): _____

Vendi dhe data: _____, _____

Nënshkrimi dhe vula (nëse ka): _____.”.

**VENDIM****Nr. 408, datë 19.6.2024****PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË
PËRFITIMIT, KRITEREVE DHE
KUSHTEVE TË VEÇANTA TË
PËRFITIMIT PËR NDËRMARRJET
MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME,
PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 11, të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e masës së përfitimit, kriterëve dhe kushteve të veçanta të përfitimit me fond për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (në vijim NMVM), për vitin 2024, të cilat synojnë rritjen e konkurrueshmërisë së tyre, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve, inovacionin dhe rinovimin e teknologjisë, zhvillimin e artizanatit, si dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse, me qëllim nxitjen drejt eksportit dhe forcimin e aftësive të NMVM-ve, lidhur me shërbimet dhe produktet për një treg të qëndrueshëm.

2. Nuk përfitojnë nga ky fond ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, të cilat kanë përfituar burime financimi nga donatorë apo institucione financiare kombëtare dhe ndërkombëtare për të njëjtët zëra apo aktivitete të lejuara nga këto projekte.

II. MASA E PËRFITIMIT, KRITERET DHE KUSHTET E VEÇANTA PËR PËRFITIMIN E FONDIT

1. Skema e mbështetjes financiare për shpenzimet korrente të programit ekonomik (04130) “Mbështetje për zhvillimin ekonomik” të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit është në vlerën 100 000 000 (njëqind milionë) lekë dhe ky fond mbulon 100% të kostove të miratuara, por jo më shumë se 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.

2. Skema e mbështetjes financiare për shpenzimet kapitale, që përdoret për mbështetjen e

projekteve të investimeve, të programit ekonomik (04130) “Mbështetje për zhvillimin ekonomik” të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit është në vlerën 51 830 000 (pesëdhjetë e një milionë e tetëqind e tridhjetë mijë) lekë, ndarë si më poshtë vijon:

a) Projekte për inovacionin, në vlerën 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, mbulon 100% të kostove të miratuara, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë;

b) Projekte për konkurrueshmërinë, në vlerën 21 830 000 (njëzet e një milionë e tetëqind e tridhjetë mijë) lekë, mbulon 100% të kostove të miratuara, por jo më shumë se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë;

c) Projekte për *start-up*-et, në vlerën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, mbulon 100% të kostove të miratuara, por jo më shumë se 800 000 (tetëqind mijë) lekë;

ç) Projekte në mbështetje të artizanatit, në vlerën 5 000 000 (pesë milionë) lekë, mbulon 100% të kostove të miratuara, por jo më shumë se 800 000 (tetëqind mijë) lekë.

3. Aplikuesit, për përfitimin e fondit, plotësojnë kriteret e përgjithshme të përcaktuara në pikën 5, të nenit 11, të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, si dhe kriteret e veçanta të lidhura me projektplanin e biznesit, si më poshtë vijon:

a) përputhshmërinë e planit të biznesit me objektin dhe qëllimet e dhënies së fondit, duke pasur në fokus nxitjen drejt eksportit dhe forcimin e aftësive të NMVM-ve, lidhur me shërbimet dhe produktet për një treg të qëndrueshëm;

b) saktësinë dhe objektivitetin e planit të biznesit, elemente të cilat identifikohen nëpërmjet rezultateve të matshme nga realizimi i tij;

c) përshkrimin e aktiviteteve që do të realizohen, i cili duhet të jetë i detajuar dhe i qartë;

ç) qartësinë e përshkrimit të impaktit dhe rezultateve të matshme;

d) të dhëna konkrete që aktivitetet e ndërmarrjes rrisin numrin e të punësuarve;

dh) të dhëna konkrete dhe të argumentuara për impaktin pozitiv mjedisor.

4. Aktivitetet e lejuara, me qëllim përfitimin e fondit, janë si më poshtë vijon:

a) Skema e mbështetjes financiare, për zërin shpenzimet korrente, mbulon shpenzimet e mëposhtme:



i. certifikimin e standardeve të prodhimit/shërbimit (përfshirë konsulencën përkatëse në fazën përgatitore);

ii. pjesëmarrjen në trajnime për rritje kapacitetesh në fusha të tilla, si menaxhimi i teknologjive digjitale/inovatore, rrjetet e prokurimit, shërbime marketingu, zhvillimi dhe modernizimi i infrastrukturës së biznesit, sisteme të reja logjistike *softwerike* apo pajisje të reja etj.;

iii. stenda të gatshme për pjesëmarrje në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare;

iv. promovimin e markës përmes digjitalizimit, përfshirë fushën audiovizuale, rrjetet sociale, eventet etj.;

v. krijimin dhe ndërtimin e aplikacioneve apo platformave, në funksion të zhvillimit të proceseve lidhur me tregtinë elektronike/*e-commerce*, produkteve të reja dhe/ose shërbimeve për të përmbushur kërkesat e industrisë së tregut në vend dhe në rajon për të përmirësuar biznesin, sistemet logjistike etj.;

vi. përgatitjen e materialeve promovuese, si: banera, fletëpalosje, katalogë, broshura për përmirësim të imazhit të NMVM-ve (jo më shumë se 20% e koston totale të projektit);

b) Skema e mbështetjes financiare, për zërin shpenzimet kapitale, mbulon shpenzimet e mëposhtme:

b.1) Projekti për inovacionin:

i. zhvillimin/përmirësimin teknologjik të produktit;

ii. blerjen e aplikacioneve për shërbim klienti apo menaxhim të dhënash;

iii. blerjen e aplikacioneve dhe/ose të programeve apo paketave të ndryshme të programeve kompjuterike;

b.2) Projekti për konkurrueshmërinë, blerjen e makinerive dhe/ose pajisjeve të punës që ndikojnë në rritjen e prodhimit dhe të përmirësimit të cilësisë së produktit;

b.3) Projekti për *start-up*-et:

i. blerjen e makinerive dhe/ose pajisjeve të punës;

ii. blerjen e aplikacioneve dhe/ose programeve *e-commerce*;

b.4) Projekti për mbështetjen e artizanatit:

i. blerjen e makinerive dhe/ose pajisjeve të punës, tradicionale dhe teknologjike për të përmirësuar kushtet e punës për biznesin;

ii. blerjen e aplikacioneve dhe/ose programeve *e-commerce*.

5. Dokumentacioni i nevojshëm, që duhet të shoqërojë kërkesën për aplikim, është, si më poshtë vijon:

a) formulari i kërkesës së plotësuar;

b) formulari i buxhetit;

c) certifikata e regjistrimit në regjistrin tregtar;

ç) ekstrakti historik i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me status aktiv;

d) deklarata për kategorinë e NMVM-së, në përputhje me parashikimin e dhënë në nenin 5, të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”;

dh) vërtetim që subjekti ka paguar të gjitha detyrimet tatimore/sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, të shkarkuar nga “*e-Albania*”;

e) vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave që ka paguar detyrimet doganore, në rastin kur NMVM-ja është eksportuese, të shkarkuar nga “*e-Albania*”;

ë) formulari i deklarimit të të ardhurave/pasqyrat financiare të vitit të fundit, të certifikuar nga administratori i NMVM-së;

f) kopje të ID-së të administratorit të NMVM-së ose prokurë përfaqësimi dhe ID-ja e përfaqësuesit, në rast se aplikuesi nuk është administratori i NMVM-së;

g) dëshmi penaliteti të drejtuesit ekzekutiv/administratorit, të rifreskuar (jo më shumë se 30 ditë nga data e aplikimit për fonde), e shkarkuar nga “*e-Albania*”;

gj) çdo dokument tjetër shoqërues, që në vlerësimin e aplikuesit, mbështet aplikimin e tij/saj.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet në rrugë elektronike, në adresën ndermarrje@aida.gov.al, nënshkruar dhe vulosur nga aplikuesi, origjinal ose kopje e njëzuar me origjinalin.

6. Disbursimi i fondit do të bëhet me dy këste, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 539, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, funksionimin, shpërblimin e anëtarëve të Bordit Vlerësues të Kërkesave, si dhe procedurën konkurruese për dhënie e granteve për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme”, të ndryshuar.

7. Procedura konkurruese, kostot e mbulueshme dhe formularët do të detajohen në rregulloren për funksionimin e mbështetjes me fonde të NMVM-ve, e cila i bashkëlidhet vendimit



nr. 539, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, funksionimin, shpërblimin e anëtarëve të Bordit Vlerësues të Kërkesave, si dhe procedurën konkurruese për dhënien e granteve për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme”, të ndryshuar.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM

Nr. 4, datë 18.6.2024

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR PROCEDURËN DHE AFATET E DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT NGA PËRMBARUESI GJYQËSOR SHTETËROR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizmin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 30, pika 2, të ligjit nr. 8/2023, “Për shërbimin përbarimor gjyqësor shtetëror”,

UDHËZOJ:

1. Në rast se përbaruesi gjyqësor shtetëror largohet nga detyra, dorëzon në zyrën përbarimore vendore, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, dokumentin e identifikimit profesional, si dhe dokumentacionin mbi çështjet përbarimore të papërfunduara në proces ekzekutimi.

2. Kryetari i zyrës përbarimore vendore përcakton me urdhër detyrimin për dorëzimin e dokumentit të identifikimit profesional dhe dokumentacionit mbi çështjet përbarimore të papërfunduara në proces ekzekutimi, si dhe ngritjen e një komisioni për marrjen në dorëzim të këtij dokumentacioni.

3. Për marrjen e dokumentit të identifikimit profesional, përbaruesi gjyqësor shtetëror që largohet nga detyra ose në mungesë të tij, personi i ngarkuar prej tij përmes prokurës së posaçme, njoftohet të paktën 5 (pesë) ditë përpara për ditën dhe orën e dorëzimit, përmes shërbimit postar dhe në rrugë elektronike. Njoftimi nëpërmjet shërbimit postar kryhet përmes postës së porositur.

4. Kur përbaruesit gjyqësor shtetëror që largohet nga detyra ose personit të ngarkuar prej tij nuk i dihet vendbanimi, si dhe kur njoftimi nuk mund të kryhet në asnjë prej vendeve të përcaktuara në nenin 151, të Kodit të Procedurës Administrative, kryhet njoftimi publik sipas parashikimit të nenit 162, të Kodit të Procedurës Administrative.

5. Komisioni i marrjes në dorëzim merr në dorëzim dokumentin e identifikimit profesional dhe dokumentacionin mbi çështjet përbarimore të papërfunduara në proces ekzekutimi, me procesverbal të nënshkruar nga të gjithë anëtarët dhe përbaruesi gjyqësor shtetëror që largohet nga detyra ose personi i autorizuar prej tij.

6. Në qoftë se përbaruesi gjyqësor shtetëror që largohet nga detyra ose personi i autorizuar prej tij refuzon nënshkrimin e procesverbalit ose nuk paraqitet, edhe pas njoftimit të kryer sipas pikave 3 dhe 4 të këtij udhëzimi, komisioni i marrjes në dorëzim bën shënimin përkatës në procesverbal. Kur është e mundur, komisioni i marrjes në dorëzim e vërteton faktin e refuzimit të nënshkrimit ose mos paraqitjes me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm.

7. Komisioni i marrjes në dorëzim i dorëzon kryetarit të zyrës përbarimore çështjet përbarimore të papërfunduara. Kryetari cakton me urdhër përbaruesin gjyqësor shtetëror zëvendësues për këto çështje. Deri në datën e caktimit të përbaruesit gjyqësor shtetëror zëvendësues, këto dosje ruhen në zyrën përbarimore vendore.

8. Dokumenti i mjetit të identifikimit profesional nxirret jashtë përdorimit me procesverbal nga një komision i përcaktuar me urdhër të kryetarit të zyrës përbarimore, në të cilin përfshihen dy përbarues gjyqësorë nga zyra përbarimore vendore dhe specialisti i financës pranë zyrës përkatëse.

9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit, përbaruesit gjyqësorë shtetërorë



dhe zyrat përmbartimore vendore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

10. Ngarkohet sektori i arkiv-protokollit për njoftimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

UDHËZIM
Nr. 7, datë 24.6.2024

**PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË
PARAVE DHE FINANCIMIN E
TERRORIZMIT NË SISTEMIN
TATIMOR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 28, pika 3, shkronja “c”, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, ministri i Financave,

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi

Qëllim i këtij udhëzimi është rregullimi në mënyrë të hollësishme i mënyrave dhe i procedurave për raportimin nga administrata tatimore, si dhe shkëmbimit të informacionit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Agjencisë të Inteligjencës Financiare, në cilësinë e autoritetit përgjegjës.

Neni 2
Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë udhëzim do të kenë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 2, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1, të këtij neni, për qëllim dhe zbatim të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm do të kenë këtë kuptim:

a) “Tatimpagues” ka të njëjtin kuptim sipas

ligjit në fuqi për procedurat tatimore;

b) “Raport i aktivitetit të dyshimtë (RAD)” është formulari që plotësohet nga organet tatimore, sipas aneksit I bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi, i cili raportohet menjëherë tek autoriteti përgjegjës, në çdo rast, jo më vonë se 72 orë pas regjistrimit të veprimit, për çdo dyshim, sinjalizim, njoftim ose të dhënë që ka të bëjë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

c) “Treguesit e aktivitetit të dyshimtë të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” janë përmbledhur në aneksin II, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi.

Neni 3
Raportimi i aktivitetit të dyshimtë

1. Organet tatimore i raportojnë autoritetit përgjegjës, menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 72 orë pas regjistrimit të veprimit, për çdo dyshim, sinjalizim, njoftim ose të dhënë, që ka të bëjë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, sipas formularit në aneksin I bashkëlidhur.

2. Formularët e raportimeve të rasteve të dyshimta shoqërohen bashkëlidhur shkresës shoqëruese me të gjithë dokumentacionin mbi transaksionin e kryer dhe tatimpaguesin që kryen transaksionin.

Bashkëngjitur këtij udhëzimi, në aneksin II, janë pasqyruar treguesit e modeleve të dyshimta të përdorura si standarde ndërkombëtare dhe kombëtare, orientuese për zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për t’u marrë në konsideratë nga organet tatimore.

Neni 4
**Masat organizative nga Drejtoria e
Përgjithshme e Tatimeve**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve krijon një sistem të centralizuar përgjegjës për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave, në funksion të përmbushjes së detyrimeve të këtij udhëzimi. Për këtë qëllim, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve krijon dhe organizon një njësi/strukturë qendrore, e cila është përgjegjëse



për identifikimin dhe mbledhjen e transaksioneve të dyshimta. Drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve cakton një person përgjegjës me pozitë drejtuese ose drejtori të varësisë, të cilët shërbejnë si person/njësi kontakti me Agjencinë e Inteligjencës Financiare, si dhe persona përgjegjës në çdo drejtori rajonale tatimore, të cilët shërbejnë si pika kontakti me personin përgjegjës në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Marrëdhëniet dhe funksionaliteti i njësisë/strukturës qendrore rregullohen në mënyrë të detajuar me akte të brendshme të Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve.

2. Drejtuesi i njësisë/strukturës qendrore raporton drejtpërdrejt te drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

3. Njësia/struktura qendrore ka këto kompetenca dhe detyra:

a) organizon procesin e monitorimit dhe siguron kryerjen e detyrave të përcaktuara nga ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

b) analizon çdo të dhënë apo informacion që është njoftuar si e dyshimtë apo ka konstatuar nëpërmjet punonjësve të vet, në funksion të dërgimit të RAD-it në Agjencinë e Inteligjencës Financiare;

c) nëse informacioni vlerësohet si i dyshimtë, personi përgjegjës dërgon RAD-in në Agjencinë e Inteligjencës Financiare;

d) organizon trajnime periodike për strukturat përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, sipas profilit të tyre të punës, në lidhje me detyrimet ligjore në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe tipologjitë përkatëse që lidhen me këto fusha;

e) përgatit raport me shkrim, të paktën një herë në vit, për detyrimet e mësipërme, duke përfshirë numrin e raporteve të dyshimta të identifikuara, tipologjitë e tyre apo të dhëna të tjera që çmohen me interes dhe ia dorëzon drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

4. Njësia/struktura qendrore në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve ka akses në çdo informacion të nevojshëm që disponon Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për të përmblusur funksionet e saj, duke ruajtur konfidencialitetin për natyrën e aktiviteteve të kryera.

5. Drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ngarkon kontrollin e

brendshëm apo struktura të tjera të përshtatshme, për të kontrolluar përputhshmërinë e punonjësve në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve lidhur me detyrimet e këtij udhëzimi.

Neni 5

Shkëmbimi i informacionit

1. Informacioni i shkëmbyer ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Agjencisë së Inteligjencës Financiare kryhet mbi bazat e konfidencialitetit reciprok.

2. Kur Agjencia e Inteligjencës Financiare ka bllokuar ose përgatitet të bllokojë një transaksion për 72 orë dhe kërkon informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ky informacion duhet t'i vihet në dispozicion brenda 48 orëve. Kjo kërkesë mund të bëhet me shkrim ose verbalisht. Çdo kërkesë verbalisht do të dokumentohet me shkrim brenda tri ditësh pune.

Neni 6

Kërkesa për mos deklarim dhe përjashtimi nga përgjegjësia ligjore për raportim

1. Punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve u ndalohet të informojnë çdo person për dërgimin apo përgatitjen për dërgim të informacionit për Agjencinë e Inteligjencës Financiare, për RAD-in, si dhe për çdo informacion që kërkohet nga Agjencia e Inteligjencës Financiare apo për hetimet/verifikimet që janë duke u kryer.

2. Punonjësit e Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve, të cilët në mirëbesim raportojnë ose japin informacion, në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare, janë të përjashtuar nga përgjegjësia penale, civile ose administrative për nxjerrjen e sekretit profesional ose bankar të përcaktuar nga legjislacioni i posaçëm në fuqi. Zgjidhja e kontratës së punës, masat disiplinore apo diskriminuese për punonjësin që përmblus detyrimin për raportim brenda Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve ose tek Agjencia e Inteligjencës Financiare konsiderohen masa pa shkaqe të arsyeshme.



Neni 7

Dispozita të fundit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Agjencia e Inteligjencës Financiare ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi dhe të anekseve si pjesë organike të tij:

- a) aneksi I “Raporti i aktivitetit të dyshimtë” (RAD);
b) aneksi II “Treguesit e aktivitetit të dyshimtë

të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

2. Pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzimi nr. 16 datë 16.2.2009, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave” shfuqizohet.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCEVE
Ervin Mete

ANEKS I

FORMULARI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETIT TË DYSHIMTË NGA AUTORITETET
TATIMORE

PJESA I**SUBJEKTET E PËRFSHIRA NË TRANSAKSION**Indiv ☐Person fizik ☐Person juridik ☐Përfaqësues ligjor ☐

Të dhëna për subjektin	
Emri	
Mbiemri	
Lloji i dokumentit	
Numri i dokumentit të identifikimit	
Datëlindja (individ)	
Adresa	
Emri i shoqërisë	
NUIS-i	
Lloji i aktivitetit kryesor	
Selia	

PJESA II**INFORMACION MBI AKTIVITETIN E DYSHIMTË**

Data e kryerjes së aktivitetit të dyshimtë: ____/____/____

Shuma e përfshirë në aktivitetin e dyshimtë: _____

Monedha: _____

Përshkrimi i rastit të aktivitetit të dyshimtë:



PJESA III

INFORMACION MBI AUTORITETIN TATIMOR QË PLOTËSON FORMULARIN

Emri: _____
Mbiemri: _____
Pozicioni i punës: _____
Adresa: _____
Nr. i telefonit: _____

ANEKS II

TREGUESIT E AKTIVITETIT TË
DYSHIMTË TË PASTRIMIT TË PARAVE
DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Lista e mëposhtme jep shembuj të treguesve të përgjithshëm të llojit të aktivitetit të tatimpaguesit:

- Tatimpaguesi drejton një organizatë bamirësie, humanitare, edukative apo tjetër, që duket e dyshimtë. Kjo në përputhje edhe me vigjilencën e zgjeruar ndaj kësaj kategorie subjektesh;

- Tatimpaguesi drejton biznesin e tij/saj (p.sh. zyrë këmbimi valutor) pa pasur një numër identifikimi të tatimpaguesit (NIPT).;

- Tatimpaguesi heziton ose kundërshton që të japë informacion, lidhur me aktivitetin e biznesit të tij ose jep dokumente të pazakonshme, ose të dyshimta për të identifikuar biznesin e tij/saj;

- Qëllimi i transaksionit të tatimpaguesit është i pakuptimtë në pikëpamje të biznesit ose nuk përputhet me biznesin/strategjinë e deklaruar të tij;

- Pasuria neto e tatimpaguesit nuk përputhet me fondet. Informacioni i dhënë nga tatimpaguesi, lidhur me burimin e fondeve, është i rremë, çorientues ose krejtësisht i gabuar;

- Kur i kërkohet, tatimpaguesi refuzon të identifikojë ose nuk arrin të tregojë burimet e ligjshme të fondeve dhe pasurive të tjera të tij/saj;

- Tatimpaguesi (ose personi i njohur publikisht si bashkëpunëtor i tij) ka një histori të diskutueshme ose ka qenë objekt i lajmeve mediatike për vepra të mundshme penale, civile apo rregullatorë;

- Përdorimi i “personave juridikë” të shumtë, me qëllimin e vetëm marrjen dhe disbursimin e fondeve;

- Zhvillimi i aktivitetit pa ndonjë qëllim të qartë biznesi në vende ose territore të identifikuar nga autoriteti përgjegjës si me rrezik të lartë;

- Tatimpaguesi është nga ose ka degë apo filiale në një vend, ose territor të identifikuar si vend me

rrezik të lartë nga FATF-ja;

- Tatimpaguesi shfaqet si agjent i një personi të padeklaruar dhe refuzon ose shmanget pa pasur arsye të ligjshme biznesi, që të japë informacion lidhur me personin ose njësinë që përfaqëson;

- Tatimpaguesi ka vështirësi për të përshkruar natyrën e biznesit të tij ose i mungojnë njohuritë e përgjithshme të industrisë së tij;

- Tatimpaguesi hap dhe mban disa regjistra kontabiliteti;

- Tatimpaguesi paraqet fatura të rreme në drejtorinë përkatëse të tatimeve;

- Tatimpaguesi, përmes personave të emëruar, përdor transaksione fasade (transaksione të cilat nuk kanë përmbajtje ekonomike);

- Tatimpaguesi kryen transaksione të shpeshta në *cash*, pavarësisht nga penalitetet;

- Llogaria e tatimpaguesit tregon transaksione të shumta në valutë ose instrumente monetare, të cilat kur mbledhen arrijnë shuma të konsiderueshme;

- Blerja dhe shitja e letrave me vlerë pa qëllim të dallueshëm, në rrethana që duken të pazakonshme dhe të palidhura me diversifikimin e investimit ose të rrezikut;

- Transaksionet që nuk i përmbahen praktikës normale në treg (p.sh. madhësisë së tregut, shpeshtësisë, çmimeve, mbylljes së parakohshme të prodhimeve me humbje), veçanërisht kur përfshihen para në dorë ose çeqe të rimbursueshme për palë të treta;

- Paga hyrëse të bëra nga çeqe të palëve të treta ose të firmosura nga disa palë;

- Tatimpaguesi i përfshirë në transaksione që nuk kanë kuptim biznesi ose strategji të dukshme investimi, ose janë në mospërputhje me strategjinë e deklaruar të biznesit të tatimpaguesit;

- Aktivitetet ose transaksionet e tatimpaguesit janë tepër komplekse;

- Tatimpaguesi përzier “pasuritë e biznesit” me ato personale;



- Llogaria e tatimpaguesit ka transferua telegrafike që nuk kanë qëllim të dukshëm biznesi prej ose për të një vend i identifikuar si rrezik për pastrim parash, parajsa të sekretit bankar, vende dhe banka *offshore* apo vend i lidhur me aktivitet terrorist (d.m.th. vende nën sanksione, vende jobashkëpunuese, kombe simpatizante);

- Tatimpaguesi bën një depozitim fondesh, me qëllim blerjen e një investimi afatgjatë të ndjekur, menjëherë pas kësaj, nga kërkesa për likuidim të pozicionit dhe transferim të të ardhurave jashtë llogarisë;

- Tatimpaguesi kërkon që transaksioni të përpunohet në mënyrë të tillë që t'i shmanget kërkesave normale për dokumentim nga ana e firmës;

- Tatimpaguesi, pa arsye bindëse ose me shenja të pazakonshme, është përfshirë në transaksione që përfshijnë lloje të caktuara letrash me vlerë, si tituj ndaj mbartësit që, megjithëse janë të ligjshme, janë përdorur në skemat mashtruese dhe aktivitet pastrimi parash (transaksione të tilla mund të kërkojnë procedura verifikimi për të vërtetuar ligjshmërinë e aktivitetit të tatimpaguesit);

- Llogaria e tatimpaguesit tregon një nivel pashpjegueshmërisht të lartë të aktivitetit të llogarisë me nivele shumë të transaksioneve të letrave me vlerë;

- Llogaria e tatimpaguesit ka hyrje fondesh ose pasurish të tjera që i kalojnë kufijtë e njohur të të ardhurave ose burimeve të tatimpaguesit;

- Transaksione të kryera në favor të palëve të panjohura;

- Transferua të qarkulluara përmes bankave të shumta vendase ose të huaja;

- Mbajtja dhe përdorimi i shumë llogarive bankare të panevojshme;

- Rivlerësimi i aseteve të shoqërisë në vlera jashtë atyre të tregut;

- Deklarimi i fitimeve tepër të larta, të cilat nuk janë të zakonshme për llojin dhe fushën në të cilën zhvillohet ky aktivitet tregtar;

- Financimi i shoqërive në vlera të larta i ortakëve, të cilat nuk janë të justifikuar qartësisht nga burime të ligjshme apo të rrjedhin nga fitimet e aktivitetit tregtar.

UDHËZIM

Nr. 12, datë 21.6.2024

PËR KRITERET PËR PAJISJEN E NXËNËSVE ME DËFTESË KLASË, DËFTESË TË ARSIMIT BAZË, DIPLOMË TË MATURËS SHTETËRORE DHE CERTIFIKATË TË MATURËS SHTETËRORE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 52 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”; të ndryshuar; dhe të shkronjës “s” të urdhrit nr. 565, datë 5.10.2023, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Nina Guga”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Kriteret për pajisjen me dëftesë klase, dëftesë të arsimit bazë, diplomë të Maturës Shtetërore dhe certifikatë të Maturës Shtetërore

1. Pajisen me dëftesë klase digjitale të gjithë nxënësit e klasave I–VIII të arsimit bazë dhe të gjithë nxënësit e klasave X deri te klasa e parafundit e arsimit të mesëm të lartë.

2. Pajiset me dëftesë digjitale të arsimit bazë nxënësi i klasës IX që është kalues në provimet kombëtare të arsimit bazë.

3. Pajiset me diplomë digjitale të Maturës Shtetërore dhe me certifikatë digjitale të Maturës Shtetërore nxënësi që është kalues në provimet kombëtare, të detyruara dhe me zgjedhje, të Maturës Shtetërore.



Neni 2

Formati i dëftesave të klasave, dëftesës së arsimit bazë, diplomës së Maturës Shtetërore dhe certifikatës së Maturës Shtetërore

Formati i dëftesave digjitale të klasave, i dëftesës digjitale të arsimit bazë, i diplomës digjitale të Maturës Shtetërore dhe i certifikatës digjitale të Maturës Shtetërore është i njësuar për të gjitha shkollat publike dhe private.

KREU II

PËRMBAJTJA E DËFTESAVE DIGJITALE TË KLASAVE

Neni 3

Përmbajtja e faqes së parë të dëftesave digjitale të klasave

1. Dëftesa digjitale e klasës, së bashku me elementet e saj, gjenerohet nga Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP), në gjuhën shqipe.

2. Format i dëftesave digjitale të klasave përmban:

- a) stemën e Republikës së Shqipërisë;
- b) emërtimin “Republika e Shqipërisë”;
- c) emërtimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- d) emërtimin e institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, në juridiksionin e të cilit është shkolla;
- e) emërtimin e shkollës;
- f) bashkinë;
- g) vitin shkollor;
- h) klasën dhe nivelin arsimor (“Dëftesë për klasën e tretë të arsimit fillor”/“Dëftesë për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët”, “Dëftesë për klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë”);
 - i) numrin e amzës;
 - j) numrin personal;
 - k) emrin, atësinë dhe mbiemrin e nxënësit;
 - l) vendlindjen;
 - m) datëlindjen;
 - n) notën mesatare vjetore;
 - o) numrin e mungesave (gjithsej, të arsyetuara dhe të paarsyetuara);
 - p) kalimin ose mbetjen në klasë;
 - q) datën (e gjeneron sistemi);
 - r) emrin dhe mbiemrin e mësuesit të

klasës/mësuesit kujdestar dhe të drejtorit të shkollës.

Neni 4

Përmbajtja e faqes së parë të dëftesës digjitale të arsimit bazë

1. Dëftesa digjitale e arsimit bazë, së bashku me elementet e saj, gjenerohet nga SMIP-i në gjuhën shqipe.

2. Format i dëftesës digjitale të arsimit bazë përmban:

- a) stemën e Republikës së Shqipërisë;
- b) emërtimin “Republika e Shqipërisë”;
- c) emërtimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- d) emërtimin e institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, në juridiksionin e të cilit është shkolla;
- e) emërtimin e shkollës;
- f) bashkinë;
- g) vitin shkollor;
- h) emërtimin “Dëftesë e arsimit bazë për klasën e nëntë të arsimit të mesëm të ulët”;
- i) numrin e amzës;
- j) numrin personal;
- k) emrin, atësinë dhe mbiemrin e nxënësit;
- l) vendlindjen;
- m) datëlindjen;
- n) vlerësimet e provimeve kombëtare;
- o) notën mesatare vjetore;
- p) numrin e mungesave (gjithsej, të arsyetuara dhe të paarsyetuara);
- q) kalimin ose mbetjen në klasë;
- r) datën (e gjeneron sistemi);
- s) emrin dhe mbiemrin e mësuesit të klasës/mësuesit kujdestar dhe të drejtorit të shkollës;

Neni 5

Përmbajtja e faqes së dytë të dëftesave digjitale të klasave dhe e dëftesës digjitale të arsimit bazë

Faqja e dytë e dëftesave digjitale të klasave dhe e dëftesës digjitale të arsimit bazë përmban:

1. Rezultatet vjetore të nxënësit: fusha, lënda, nota përfundimtare dhe vlerësimi i kompetencave sipas kurrikulës.

2. Vulën digjitale të shkollës.



KREU III
PËRMBAJTJA E DIPLOMËS DIGJITALE
TË MATURËS SHTETËRORE
DHE E CERTIFIKATËS DIGJITALE TË
MATURËS SHTETËRORE

Neni 6

**Përmbajtja e diplomës digjitale të Maturës
Shtetërore**

1. Diploma digjitale e Maturës Shtetërore, së bashku me elementet e saj, gjenerohet nga sistemi, në gjuhën shqipe dhe në anglisht.

2. Përmbajtja e diplomës digjitale të Maturës Shtetërore është si më poshtë vijon:

- a) stema e Republikës së Shqipërisë;
- b) emërtimi “Republika e Shqipërisë”;
- c) emërtimi i ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- d) viti shkollor;
- e) shkolla;
- f) emërtimi i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, në juridiksionin e të cilit është shkolla;
- g) titulli “DIPLOMË E MATURËS SHTETËRORE”;
- h) përmbajtja pas titullit:
“Në përfundim të arsimit të mesëm të lartë

I jepet _____

(emri, atësia, mbiemri)

ID e maturës: _____

Lindur në _____,

më _____

Tiranë, më _____

Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës
së Shërbimeve Arsimore

(_____)

(vula elektronike)

Diploma është e vlefshme me certifikatën e notave.”

Neni 7

**Përmbajtja e faqes së parë të certifikatës
digjitale të Maturës Shtetërore**

1. Certifikata e Maturës Shtetërore është konceptuar bazuar në gjenerimin e të dhënave nga sistemi SMIP-i, në gjuhën shqipe.

2. Faqja e parë e certifikatës së Maturës Shtetërore përmban:

- a) stemën e Republikës së Shqipërisë;

b) emërtimin “Republika e Shqipërisë”;

c) emërtimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin (për shkollat profesionale në krah është edhe ministria përgjegjëse për arsimin profesional);

d) emërtimin e institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, në juridiksionin e të cilit është shkolla;

e) emërtimin e shkollës;

f) bashkinë;

g) seksionin dygjuhësh, duke përcaktuar gjuhët e zhvilluara (gjenerohet nga SMIP-i);

h) numrin e amzës;

i) ID-në e maturës;

j) emërtimin e certifikatës: “Certifikatë e Maturës Shtetërore” dhe “Certifikatë e Maturës Shtetërore Profesionale” (gjenerohet nga SMIP-i);

k) emrin, atësinë dhe mbiemrin e nxënësit;

l) vendlindjen;

m) datëlindjen”;

n) vitin shkollor;

o) drejtimin dhe nivelin e studimeve për shkollën profesionale (gjenerohet nga SMIP-i);

p) notën mesatare;

q) provimet e detyruara të Maturës Shtetërore (lënda dhe nota gjenerohen nga sistemi);

r) provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore (lënda dhe nota gjenerohen nga sistemi);

s) datën (e gjeneron sistemi);

t) emrin dhe mbiemrin e drejtorit të shkollës;

u) shënimin “Nota më e vogël kaluese është 5 (pesa). Nota më e lartë është 10 (dhjeta).

Neni 8

**Përmbajtja e faqes së dytë të certifikatës
digjitale të Maturës Shtetërore**

Faqja e dytë e certifikatës digjitale të Maturës Shtetërore përmban:

1. Emrin, atësinë dhe mbiemrin e nxënësit.

2. ID-në e Maturës.

3. Përmbledhjen e rezultateve të nxënësit në arsimin e mesëm të lartë: fusha, lënda, nota përfundimtare për çdo vit shkollor.

4. Vlerësimet e provimeve përfundimtare të nivelit (për arsimin profesional).

5. Notën mesatare të të gjitha viteve të shkollimit në arsimin e mesëm të lartë, notën mesatare të provimeve të Maturës Shtetërore, notën mesatare të përllogaritur si mesatare e thjeshtë e treguesve, si vijon: a) mesatarja aritmetike



e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë; b) mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore.

6. Vulën digjitale të shkollës.

KREU IV AMZA DIGJITALE

Neni 9 Numri i amzës

Numri i amzës digjitale do të gjenerohet nga SMIP-i si një numër kombëtar unik, duke filluar nga viti shkollor 2024–2025 e në vijim.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 10 Shfuqizime

Udhëzimi nr. 28, datë 2.8.2013, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për pajisjen e nxënësve me dëftesë klase”, shfuqizohet.

Neni 11 Zbatimi i udhëzimit

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, njësitë arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESMINISTËR I MINISTRIË SË
ARSIMIT DHE SPORTIT
Nina Guga

UDHËZIM I PËRBASHKËT Nr. 106, datë 14.6.2024

MBI KUFIZIMET NË QARKULLIMIN E MJETEVE TË RËNDA PËR TRANSPORTIN RRUGOR TË MALLRAVE PËRGJATË SEZONIT TURISTIK VEROR DHE FESTAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 6, të ligjit nr. 8378, datë 27.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuare; nenit 5 të VKM-së nr. 153, datë 7.4.2000, “Rregullorja për zbatimin e Kodit Rrugor”, të ndryshuar, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministri i Brendshëm

UDHËZOJNË:

Vendosjen e kufizimeve për qarkullimin në rrugët jashtë qendrave të banuara të automjeteve rrugore shqiptare dhe të huaja, me kushtet dhe përjashtimet që përcaktohen në këtë udhëzim.

Neni 1

Kufizimet e qarkullimit të mjeteve për transportin e mallrave, me masë totale maksimale të autorizuar mbi 7,5 tonë, në autostrada, rrugë interurbane dhe urbane kryesore e dytësore që përfshijnë zonat turistike gjatë sezonit turistik veror, ditët e festave dhe ditë të tjera të veçanta, që paraprijnë, pasojnë ose u shtohen ditëve të festave.

“Fundjava” nënkupton pasditen e ditës së premte, ditën e shtunë dhe të diel, e cila fillon në orën 15:00 të ditës së premte dhe përfundon në orën 24:00 të ditës së diel;

“Ditët e festave zyrtare” nënkuptojnë datat sipas ligjit nr. 7651, datë 21.12.1992, “Për festat zyrtare”, të ndryshuar, dhe të publikuara nga Banka e Shqipërisë për vitin në vazhdim;

“Sezoni turistik veror”, për qëllimin e këtij udhëzimi, nënkupton periudhën nga data 15 qershor deri më 15 shtator të vitit në vijim.

Neni 2

Kufizimet e qarkullimit vendosen në rrugët jashtë dhe në hyrje të qendrave të banuara, për:



- a) ditët e festave;
- b) ditë të tjera të veçanta, që paraprijnë, pasojnë ose u shtohen ditëve të festave.

Neni 3

Ndalohet qarkullimi i mjeteve rrugore ose kombinimit të tyre, që ndikojnë në rrjedhshmërinë e qarkullimit dhe në kushtet e sigurisë rrugore, në segmentet rrugore për përdorim publik, të parashikuara në aneksin 2 të këtij udhëzimi, përveç atyre që parashikohen në nenin 5 të këtij udhëzimi, si më poshtë:

- a) për transportin e mallrave me peshë të përgjithshme të autorizuar mbi 7.5 tonë;
- b) me ngarkesë të pandashme, me gjatësi maksimale më të madhe se 12 m (transportet me mjete jashtë norme ose transportet në kushte jonormale);
- c) makinat bujqësore, makinat teknologjike vetëlëvizëse ose traktorët me rrota që kanë shpejtësi më të vogël se 40 km/orë;
- d) makinat bujqësore dhe teknologjike, që kalojnë përmasat kufitare, sipas nenit 61 të ligjit nr. 8378, datë 27.7.1998, të ndryshuar (gjerësi maksimale jo më të madhe se 2,55 m, lartësi maksimale jo më të madhe se 4 m, gjatësi të përgjithshme, jo më të madhe se 7.50 m për mjetet me një aks dhe 12 m për mjetet teke me dy e më shumë akse);
- e) Mjetet për kursantët e autoshkollave mësimore.

Neni 4

Zbatimi i kufizimit të qarkullimit të mjeteve të përcaktuara në nenet përkatëse të këtij udhëzimi do të bëhet për periudhën nga data 15 qershor deri më 15 shtator, për ditët e fundjavës përfshirë dhe ditën e premte, si më poshtë:

Kufizimet shtrijnë efektin:

- a) Për ditët e fundjavës:
 - për ditët e premte nga ora 15:00 deri në orën 24:00;
 - për ditët e shtuna nga ora 07:00 deri në orën 24:00;
 - për ditët e diela nga ora 07:00 deri në orën 24:00;
- b) Për ditët e festave gjatë sezonit turistik:
 - për ditët e festave zyrtare, oraret e kufizimit

të qarkullimit janë nga ora 15:00 e ditës para festës deri në orën 22:00 dhe nga ora 07:00 e ditës së festës deri në orën 24:00 të po asaj dite.

c) Për ditët e festave lokale;

- për ditët e festave lokale, kufizimet vendosen nga organet e Policisë Rrugore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake përkatëse.

d) Kufizimet e qarkullimit kur ka më shumë se një ditë feste kombëtare:

- në rastet kur festa kombëtare zgjat më shumë se një ditë (festat e 28 e 29 Nëntorit, si dhe festa e 1 dhe 2 janar), kufizimet fillojnë nga ora 17:00 e ditës para festës deri në orën 22:00 të po asaj dite. Në ditën e parë të festës kufizimet fillojnë në orën 08:00 dhe vijojnë deri në orën 22:00 të po asaj dite. Në ditën e dytë të festës, kufizimet fillojnë në orën 12:00 dhe vijojnë deri në orën 24:00 të po asaj dite.

Gjatë periudhës së ndalimit, mjetet e regjistruara në Shqipëri, për të cilat zbatohet ky udhëzim, lejohen të hyjnë në Shqipëri përmes pikave kufitare të shprehura në aneksin 1, dhe duhet të shkojnë në zyrën doganore më të afërt.

Neni 5

1. Përfshihen nga ndalimi i parashikuar në këtë udhëzim mjetet e mëposhtme:

- a) automjetet e Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit;
- b) automjetet e Forcave të Armatosura;
- c) automjetet për mirëmbajtjen e rrugëve, instalimet elektrike dhe mjete të ngjashme, si dhe mjetet për shpërndarjen e postës dhe gazeta;
- d) mjetet që i përkasin radios dhe televizionit;
- e) cisternat që transportojnë ujë të pijshëm;
- f) mjetet që transportojnë materiale ose pajisje për përdorim në situata të jashtëzakonshme;
- g) kamionë që transportojnë ushqime që prishen, të tilla si: mish i freskët, qumësht të papërpunuar dhe produkteve të qumështit të freskët, peshk të freskët dhe prodhimeve të detit, fruta dhe perime që prishen;
- h) kamionë që transportojnë shpendë dhe bagëti të gjalla;
- i) mjetet për mallrat e destinuara për ushqimin e kafshëve të fermave, për periudha e nevojshme për zgjidhjen e kritikës së furnizimit.

2. Automjetet me peshë dhe përmasa sipas nenit 3, lejohen të lëvizin (në rastet kur periudha



kohore e kufizimit i gjen të futura në territorin e vendit tonë), vetëm për shkak të regjimit/procedurave doganore, të kohës dhe rrethanave, në veçanti kur transporti i domosdoshëm për arsye të sigurisë, ose për shkak se vonesat mund të sjellin dëme të konsiderueshme materiale.

3. Gjatë periudhës së kufizimit, mjetet me targa regjistrimi të huaja me peshë të përgjithshme të autorizuar mbi 7.5 tonë ose mbi 12 m gjatësi, nuk mund të hyjnë në Shqipëri, por mund të përdorin vendin/sheshin e parkimit në zonën/pikën përkatëse të kalimit kufitar.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ose i autorizuari prej tij, për rastet e furnizimeve kritike të porteve dhe aeroporteve, apo transporteve për qëllime mjekësore dhe humanitare, rast pas rasti, mbi bazën e kontratave/dokumentacionit që arsyetojnë domosdoshmërinë e transportit, me autorizim

mund të vendosë përjashtime me afat dhe itinerar të përcaktuar, nga kufizimet e mësipërme.

Neni 6

Udhëzimi i përbashkët nr. 7967, datë 30.5.2018, “Mbi kufizimet në qarkullimin e mjeteve të rënda për transportin rrugor të mallrave përgjatë sezonit turistik dhe festave”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË

Belinda Balluku

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla

ANEKSI 1 PIKAT E KALIMIT KUFITAR

Pikat e kalimit të kufirit, më poshtë “PKK”, jepen si vijon:

Nr.	PIKAT E KALIMIT TOKËSOR TË KUFIRIT
1	Pika e kalimit të kufirit me Malin e Zi:
1.1	- Hani i Hotit;
1.2	- Muriqan.
2	Pika e kalimit të kufirit me Maqedoninë e Veriut:
2.1	- Bllatë;
2.2	- Qafëthanë;
2.3	- Tushemisht;
2.4	- Goricë.
3.	Pika e kalimit të kufirit me Kosovën:
3.1	- Qafëmorinë;
3.2	- Morinë.
4.	Pika e kalimit të kufirit me Greqinë:
4.1	- Kapshticë;
4.2	- Tri Urat;
4.3	- Kakavijë;
4.4	- Qafëbotë.

ANEKSI 2

SEGMENTET RRUGORE PËR TË CILAT DO TË ZBATOHET KY UDHËZIM	
SHKODËR	- Shkodër – PKK Hani i Hotit – Shkodër; - Shkodër – PKK Muriqan – Shkodër; - Shkodër – Plazhi Zogaj – Shkodër; - Shkodër – Plazhi Shirokë – Shkodër; - Shkodër – Velipojë – Shkodër; - Shkodër – Lezhë – Shkodër.
LEZHË	- Lezhë – Shëngjin – Lezhë; - Lezhë – Patok – Lezhë;



	- Lezhë – Kryqëzimi i Milotit – Kukës – PKK Morinë – Lezhë.
TIRANË	- Tiranë – Durrës – Tiranë; - Tiranë – Gjiri i Lalzit – Tiranë; - Tiranë – Vorë – Fushë-Krujë – Krujë – Tiranë.
ELBASAN	- Elbasan – Pogradec – Elbasan; - Elbasan – Rogozhinë – Elbasan.
DURRËS	- Durrës – Currila – Durrës; - Durrës – Gjiri i Lalzit – Durrës; - Durrës – Kavajë – Durrës; - Durrës – Tiranë – Durrës.
KAVAJË	- Kavajë – Rogozhinë – Kavajë; - Kavajë – Spille – Kavajë; - Kavajë – Lushnjë – Kavajë.
FIER	- Fier – Lushnjë – Fier; - Fier – Seman – Fier; - Fier – Plazhet e Poros – Fier; - Fier – Vlorë – Fier.
VLORË	- Vlorë – Zvërnec – Vlorë; - Vlorë – Palasë – Dhërmi – Vuno – Qeparo – Borsh – Bunec – Vlorë; - Vlorë – By Pass – Vlorë; - Vlorë – Fier – Vlorë.
SARANDË	- Sarandë – PKK Qafëbotë – Sarandë; - Sarandë – Butrint – Sarandë; - Sarandë – Bunec – Sarandë; - Sarandë – Tuneli i Skërfices – Sarandë.
POGRADEC	- Pogradec – Lin – PKK Qafëthanë – Pogradec; - Pogradec – PKK Tushemisht – Pogradec; - Pogradec – Elbasan – Pogradec.
TEPELENË	- Tepelenë – Gjirokastër – PKK Kakavijë – Tepelenë; - Tepelenë – Gjirokastër – Qafa e Muzinës – Tepelenë; - Tepelenë – Gjirokastër – Tuneli i Skërficës – Tepelenë.
BAJRAM CURRI	- Bajram Curri – PKK Qafë Morinë – Bajram Curri; - Bajram Curri – Valbonë – Bajram Curri.
SEGMENTET RRUGORE PËR DITËT E FESTAVE FETARE LOCALE	
	Laç – Kisha e Shën Ndout – Laç;
	Durrës – Shënavlash – Durrës;
	Berat – Mali i Tomorit – Berat.

URDHËR**Nr. 110, datë 21.6.2024****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Brendshme, nga data 24.6.2024 deri më datë 28.6.2024, zëvendësministrit të Brendshëm, z. Julian Hodaj.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Brendshëm, z. Julian Hodaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM**Taulant Balla**



URDHËR
Nr. 333, datë 18.6.2024

Neni 2
Përkufizime

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË
FORMIMIT VAZHDUES PËR
PËRMBARUESIT GJYQËSORË
SHTETËRORË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 22, pika 3, të ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”

URDHËROJ:

1. Miratimin e Programit të Formimit Vazhdues për Përmbaruesit Gjyqësorë Shtetërorë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit dhe institucionet trajnuese për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

PROGRAMI
I FORMIMIT VAZHDUES PËR
PËRMBARUESIT GJYQËSORË
SHTETËRORË

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky program përcakton objektivat, modulet e trajnimit, organizimin e trajnimeve dhe kohëzgjatjen e tyre, rregullat e frekuentimit, mënyrën e kontrollit të njohurive dhe aftësive, si dhe rregulla të tjera të hollësishme për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë.

Faqe | 11284

Në këtë program termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Certifikatë” është vërtetimi i lëshuar nga institucioni trajnues për përfundimin me sukses të trajnimit në programin e formimit të detyrueshëm vazhdues;

b) “Ditë trajnimi” është dita e trajnimit në programin e formimit vazhdues, që realizohet në jo më pak se 5 orë;

c) “Formimi vazhdues” nënkupton programin e detyrueshëm të formimit vazhdues për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë, i cili bazohet në trajnimet profesionale vazhduese të organizuar nga institucionet trajnuese, ku pjesëmarrësit kryejnë përditësimin e njohurive dhe zhvillimin e kompetencave të tyre, nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnimet që do të zhvillohen, bazuar në procedurat, kriteret dhe standardet e parashikuara në ligj dhe akte nënligjore;

ç) “Institucion trajnues” nënkupton Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit, Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, organet drejtuese të dhomave të profesioneve të lira apo institucione të tjera të interesuara, sipas marrëveshjeve të lidhura me Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit.

KREU II
OBJEKTIVAT E PROGRAMIT DHE
MODULET E TRAJNIMIT

Neni 3
Objektivat e programit të detyrueshëm të
formimit vazhdues

Objektivat e këtij programi konsistojnë në:

a) ofrimin e një programi trajnimi të përshtatshëm për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë që mundëson përditësimin e njohurive për legjislacionin procedural civil, ligjin për përmbarimin gjyqësor shtetëror, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e përmbaruesit gjyqësor shtetëror dhe zhvillimin e procedurave përmbarimore, si dhe përditësimin e njohurive të tyre me zhvillimet e legjislacionit në fuqi;

b) zhvillimin e një programi formimi vazhdues trajnues, që mundëson zhvillimin e kompetencave



dhe përditësimin e njohurive në zbatimin e detyrave dhe në ushtrimin e profesionit të përmbaruesit;

c) përmirësimin e kapaciteteve profesionale dhe aftësive praktike, ngritjen profesionale të përmbaruesve në përmbushjen e veprimtarisë sipas legjislacionit në fuqi dhe krijimin e praktikave të unifikuara përmbarimore;

ç) nxitjen e aftësive të komunikimit dhe të bashkëpunimit me palët gjatë procedurës përmbarimore dhe në komunikimin me personat e tretë;

d) nxitjen e frymës së bashkëpunimit profesional ndërmjet pjesëmarrësve në programin e formimit vazhdues, përmes trajnimeve përkatëse.

Neni 4

Synimi për kualifikim

Zhvillimi profesional i pjesëmarrësve në formimin vazhdues arrihet duke përvetësuar kompetencat e mëposhtme:

a) njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme për performancë të suksesshme profesionale si përmbarues gjyqësor shtetëror dhe përmirësimin e shërbimit përmbarimor;

b) aftësinë për t'u përballur me kërkesa dhe sfida që ndryshojnë në mënyrë të vazhdueshme;

c) aftësinë për të zbatuar kompetencat e kërkuara drejtpërsëdrejti në punë (profesionale dhe personale);

ç) aftësinë për kërkime të pavarura në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm profesional;

d) kërkesat për menaxhimin dhe përmbushjen me sukses të procesit të punës (vetorganizimi dhe disiplina, aftësia për t'u përballur me ngarkesë të lartë pune).

Neni 5

Metodat dhe programi i formimit vazhdues

1. Përmbajtja e programit të detyrueshëm të formimit vazhdues reflekton zhvillimin e kompetencave profesionale të pjesëmarrësve, i cili fokusohet në përmirësimin e aftësive praktike dhe vlerave etike të tyre, kryesisht në:

a) ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve profesionale për legjislacionin vendës dhe ndërkombëtar;

b) hartimin e akteve dhe kryerjen e veprimeve procedurale përkatëse në funksion të ushtrimit të kompetencave, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) zbatimin e rregullave etike;

ç) përshtatjen me rrethana dhe situata specifike gjatë ushtrimit të kompetencave;

d) zhvillimin e aftësive në fushën e përmbarimit gjyqësor;

dh) zhvillimin e praktikave me institucionet e ndërlidhura me punën e përmbaruesve shtetërorë;

e) zhvillimin e kapaciteteve hulumtuese, organizative dhe menaxhuese.

2. Kompetencat e mësipërme do të zhvillohen nëpërmjet moduleve të formimit vazhdues, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij programi dhe pjesë përbërëse e tij, trajnimit praktik, si dhe punës praktike që mund t'i caktohet nga trajnerët.

KREU III

ORGANIZIMI I PROGRAMIT, KOHËZGJATJA DHE RREGULLAT E FREKUENTIMIT

Neni 6

Organizimi i programit të detyrueshëm të formimit vazhdues

1. Institucioni trajnues organizon programin e formimit vazhdues mbi bazën e një planifikimi vjetor.

2. Institucioni trajnues merr masat e nevojshme administrative dhe akademike dhe kujdeset në mënyrë të posaçme për trajnimin vazhdues të përfituesve duke ofruar programe të formimit vazhdues dhe veprimtari të tjera trajnuese.

3. Përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë detyrohen që, jo më pak se dy herë në vit, të jenë pjesëmarrës në trajnimet e detyrueshme vazhduese.

4. Programi tematik dhe kalendari i të gjitha aktiviteteve që do të zhvillohen në kuadër të trajnimeve vazhduese, së bashku me metodologjinë e trajnimit, modelin e formularit të regjistrimit, publikohet elektronikisht në faqen zyrtare të institucionit trajnues dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.



Neni 7

Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të trajnimeve në formimin vazhdues

1. Trajnimet përcaktohen në fillim të çdo viti kalendarik dhe publikohen në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit. Çdo ndryshim në kalendarin e trajnimeve njoftohet jo më vonë se një muaj nga koha e zhvillimit të trajnimit.

2. Trajnimet e formimit vazhdues organizohen si trajnim njëditor (në jo më pak se 5 orë) apo si trajnim dyditor i quajtur “cikël trajnimi” (në jo më pak se 10 orë). Pjesëmarrësi në ciklin e trajnimit u nënshtrohet rregullave specifike të hartuara për një trajnim të tillë.

3. Trajnimet e formimit vazhdues mund të organizohen në formën e leksioneve/*workshop*-eve apo mënyrave të tjera interaktive dhe tematikat lidhen kryesisht, por pa u kufizuar, me legjislacionin e shërbimit përmbarrimor, fushën e së drejtës civile dhe procedurale civile, ekzekutimin përmbarrimor, aspekte të veçanta të fushës së të drejtës publike, rregullat mbi etikën profesionale të përmbarruesve.

4. Temat e trajnimeve përcaktohen në bashkëpunim me pedagogët/trajnerët.

5. Për raste të veçanta, nisur nga nevojat për trajnim, të ndryshimeve të legjislacionit dhe problemeve të praktikës, karakteri i programit të trajnimit vazhdues mund të lejojë përfshirjen e aktiviteteve trajnuese apo tematikave të tjera.

6. Çdo program trajnimi përmban qëllimin e trajnimit, temën e trajnimit, numrin e moduleve me temat përkatëse, kohëzgjatjen për çdo modul, si dhe çdo element tjetër të nevojshëm për pjesëmarrësit në trajnim.

Neni 8

Vendi i zhvillimit të trajnimeve të programit të formimit vazhdues

Trajnimet e programit të formimit vazhdues organizohen në ambientet e institucionit trajnues ose në ambiente të tjera, të cilat mund të kontrahohen prej tij, me qëllim zhvillimin e trajnimeve dhe garantimin e aksesit të personave të konfirmuar për pjesëmarrje.

Neni 9

Regjistrimi në kurset e trajnimit të programit të formimit vazhdues

1. Institucioni trajnues njofton përmbarruesit në rrugë elektronike lidhur me programin tematik dhe kalendarin e aktiviteteve trajnuese, të cilat do të ndiqen prej tyre.

2. Çdo aktivitet trajnues publikohet në faqen elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit dhe institucionit trajnues dhe përmban të dhëna lidhur me grupin e pjesëmarrësve në të, përmbajtjen narrative ose përshkrimin e kursit të trajnimit, vendin e organizimit, kohëzgjatjen, datat e parashikuara për zhvillimin e tij, agjendën dhe mbështetjen financiare.

3. Regjistrimi në aktivitetet trajnuese është individual dhe kryhet sipas modelit të formularit të regjistrimit që publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit dhe institucionit trajnues.

4. Regjistrimi konsiderohet i vlefshëm nëse është paraqitur apo është kryer jo më vonë se tri ditë nga data e zhvillimit të trajnimit përkatës.

5. Institucioni trajnues përcakton listën e pjesëmarrësve në çdo sesion trajnues, duke marrë parasysh kërkesat individuale, si dhe referuar përcaktimeve në këtë program.

6. Çdo institucion trajnues mban një listë të pjesëmarrësve në çdo trajnim.

7. Përjashtimisht, për raste të veçanta dhe përjashtimore, për të mos penguar procesin e trajnimit, nisur nga nevojat për trajnim, institucioni trajnues mund të përditësojë listat e pjesëmarrësve dhe të aktiviteteve trajnuese në formimin vazhdues.

8. Pas miratimit të listave, institucioni trajnues procedon me njoftimin individual të personave që duhet të marrin pjesë nëpërmjet ftesave elektronike për veprimtarinë/të përkatëse trajnuese.

9. Ftesat për pjesëmarrje në aktivitetet trajnuese dërgohen në mënyrë elektronike minimalisht një muaj përpara datës së caktuar për zhvillimin e aktivitetit.



Neni 10

Pjesëmarrja në aktivitetet trajnuese të programit të detyrueshëm të formimit vazhdues

1. Institucioni trajnues mban të gjitha të dhënat e pjesëmarrjes në sesionet trajnuese të tilla, si: listën e të ftuarve në çdo aktivitet, listën e pjesëmarrësve, duke i pasqyruar të detajuara sipas sesioneve përkatëse dhe listën e të pajisurve me certifikatë. Listat përbëhen nga sesioni i paradites dhe i pasdites. Çdo pjesëmarrës është i detyruar që të firmosë prezencën e tij për të vërtetuar ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të aktivitetit në të gjitha sesionet e tij, në rast të kundërt nuk certifikohet. Kjo listë pasqyrohet edhe në një regjistrë të veçantë, nëpërmjet një numri rendor, bazuar në certifikatat e marra.

2. Institucioni trajnues mban të dhëna lidhur me fushat e trajnimit, temën e sesionit trajnues, periudhën e aktivitetit, vendin e zhvillimit, ekspertët, lehtësuesit apo moderatorët, si dhe mbështetjen financiare, nëse ka.

3. Në rastet e mospjesëmarrjes në trajnimet e programit të detyrueshëm të formimit vazhdues, veprohet në përputhje me parashikimet e ligjit për shërbimin përmbartimor gjyqësor.

KREU IV

MËNYRA E KONTROLLIT TË NJOHURIVE DHE RREGULLA TË TJERA

Neni 11

Kontroli i njohurive

1. Institucioni trajnues mund të organizojë trajnime në formën e cikleve të trajnimit, ku kryerja e një testimi apo përgatitja e një projekti, të jetë

kusht për pajisjen me certifikatë pjesëmarrje.

2. Në rastin e parashikuar në pikën 1, informacioni mbi këtë kusht bëhet i ditur që në njoftimin për organizimin e trajnimit.

3. Testimi apo projekti vlerësohet me pikë, të cilat pasqyrohen edhe në certifikatën e pjesëmarrjes.

Neni 12

Lëshimi i certifikatës së pjesëmarrjes

1. Në fund të programit të detyrueshëm për formimin vazhdues, pjesëmarrësit pajisen me certifikatën e përfundimit me sukses të trajnimit në programin e formimit vazhdues, që lëshohet nga institucioni trajnues.

2. Nuk pajisen me certifikatë pjesëmarrësit që mungojnë qoftë edhe një seancë të trajnimit në programin e formimit vazhdues. Në këtë rast, me kërkesë të tyre, pjesëmarrësit mund të marrin vërtetim vetëm për kohën që kanë frekuentuar.

Neni 13

Elementet e certifikatës së pjesëmarrjes

1. Certifikata përmban këto elemente:

- a) emrin;
- b) mbiemrin;
- c) data/t e zhvillimit të trajnimit në programin e formimit vazhdues;
- ç) titullin e programit/trajnimit;
- d) numrin e regjistrit;
- e) nënshkrimin dhe vulën e organit përgjegjës për lëshimin e tyre.

2. Në certifikatë krahas logos së institucionit trajnues vendoset edhe logoja e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit.



KREU V DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 14 Hyrja në fuqi

Ky program hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ANEKS 1 MODULET E TRAJNIMIT NË PROGRAMIN E FORMIMIT VAZHDUES

Moduli i programit të detyrueshëm të formimit vazhdues për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë	
Trajnime që përmbajnë njohuri të specializuara dhe të thelluara rreth tematikave të mëposhtme, por pa u kufizuar në to:	
1	Legislacioni mbi ekzekutimin e detyruar. Njohja dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të huaja në çështjet civile dhe tregtare.
2	Titujt ekzekutivë. Urdhri i ekzekutimit. Llojet e detyrimeve të ekzekutueshme dhe ekzekutimi i tyre. Mbi titujt ekzekutivë me objekt takim fëmije, marrje fëmije, kujdestari.
3	Detyrimi. Origjina e detyrimit. Aktet për dhënien e kredive bankare. Kontratat bankare. Detyrimet monetare.
4	Procedurat e falimentimit. Përmbarimi ndaj debitorit dhe pronave të tij.
5	Vendimet gjyqësore me ekzekutim të përkohshëm. Masat e sigurimit të padisë. Ekzekutimi i vendimeve të gjykatave administrative.
6	Paraqitja dhe hartimi i padisë, deklarata e mbrojtjes. Kundërpadia. Heqja dorë nga gjykimi dhe e drejta e padisë.
7	Njoftimet. Mënyra e njoftimit. Roli i përmbaruesit gjyqësor në procesin e njoftimeve. Rëndësia e akteve të nxjerra nga përmbaruesi gjyqësor, mënyra e komunikimit të tyre dhe rëndësia e njoftimit të palëve në proces.
8	Parashkrimi, afatet. Ndërprerja dhe pezullimi i parashkrimit. Prekluziviteti.
9	Ekzekutimi dhe shuarja e detyrimeve. Vendi, afati i ekzekutimit të detyrimit.
10	Zëvendësimi dhe kalimi i kredisë.
11	Pengu. Hipoteka. Dorëzania.
12	Preferimet (privilegjet). Radha e preferimit në procesin përmbarimor.
13	Etika dhe komunikimi. Rëndësia e Kodit të Etikës. Etika në ofrimin e shërbimit publik dhe etika deontologjike.
14	Ekzekutimi mbi sende të luajtshme dhe sende të paluajtshme. Ankandi.
15	Aktiviteti dytësor i përmbaruesit gjyqësor shtetëror.
16	Papajtueshmëritë me funksionin e përmbaruesit gjyqësor shtetëror. Konflikti i interesit. Konfidencialiteti dhe praktika të ndaluara të përmbaruesit gjyqësor shtetëror.



URDHËR
Nr. 334, datë 18.6.2024

funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”,

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
TIP, PËR MBLEDHJEN E TARIFËS SË
SUKSESIT NGA SHËRBIMI
PËRMBARIMOR SHTETËROR**

URDHËROJ:

1. Miratimin e marrëveshjes tip për mbledhjen e tarifës së suksesit nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

**FORMAT “TIP” I MARRËVESHJES PËR MBLEDHJEN E TARIFËS SË SUKSESIT, QË
LIDHET MIDIS KREDITORIT DHE ZYRËS PËRMBARIMORE VENDORE**

**MARRËVESHJE
PËR MBLEDHJEN E TARIFËS SË SUKSESIT MBI VLERËN E DETYRIMIT
TË EKZEKUTUAR NGA PËRMBARUESI GJYQËSOR SHTETËROR**

Sot, më datë ____ . ____ . ____ , në Zyrën Përmbarimore _____ , pasi kreditori paraqiti kërkesën për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv: _____ (sipas nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile, ku përshkruhen të gjitha elementet e titullit ekzekutiv, duke përfshirë llojin e aktit, numrin dhe datën), lidhet kjo marrëveshje midis:

A. **Kreditorit (subjekt fizik):** emri, atësia, mbiemri, adresa dhe numri i pasaportës/letërnjoftimit, adresë elektronike, nr. llogarie bankare, nr. tel./fax./cel. ose (person juridik): emri, NIPT-i/NUIS-i, adresa elektronike, nr. i llogarisë bankare, selia, si dhe emri, atësia, mbiemri dhe numri i pasaportës/letërnjoftimit të përfaqësuesit të tij;

dhe

B. **Zyrës Përmbarimore** _____ , adresa, nr. llogarie bankare, nr.tel./fax./cel.

Baza ligjore: lidhja dhe zbatimi i kësaj marrëveshjeje bazohet në dispozitat e Kodit Civil, në ligjin nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, udhëzimit të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave, “Për përcaktimin e nivelit minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbarimore të ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin në fuqi në momentin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

Neni 1
Objekti i kontratës

Me vullnet të lirë, palët janë dakord që, në vijim të ekzekutimit të titullit ekzekutiv “_____”, të caktojnë tarifën e suksesit, të cilat do të paguheshin sipas parashikimeve të nenit 2 të kësaj marrëveshjeje.



Opsioni 1

Neni 2

Tarifë suksesi sipas shumës së ekzekutuar

1. Titulli ekzekutiv përmban një detyrim monetar në total në vlerën _____.
2. Kreditori merr përsipër të paguajë tarifën e suksesit në llogarinë e zyrës përmbartimore në masën si më poshtë:
 - a) ____ % ose _____ lekë, kur titulli ekzekutiv në vlerën _____ ekzekutohet tërësisht dhe arkëtohet në llogarinë e kreditorit brenda afateve ligjore të treguara në Kodin e Procedurës Civile, por jo më shumë se **365 ditë** të pandërprera nga kërkesat e kreditorit për pezullimin ose moskryerjen e një veprimi të caktuar për ekzekutimin e titullit ekzekutiv;
 - b) ____ % ose _____ lekë, kur titulli ekzekutiv në vlerën _____ ekzekutohet tërësisht dhe arkëtohet në llogarinë e kreditorit brenda afateve ligjore të treguara në Kodin e Procedurës Civile, por jo më shumë se **180 ditë** të pandërprera nga kërkesat e kreditorit për pezullimin ose moskryerjen e një veprimi të caktuar për ekzekutimin e titullit ekzekutiv;
 - c) ____ % ose _____ lekë, kur titulli ekzekutiv në vlerën _____, ekzekutohet tërësisht dhe arkëtohet në llogarinë e kreditorit brenda afateve ligjore të treguara në Kodin e Procedurës Civile, por jo më shumë se **120 ditë** të pandërprera nga kërkesat e kreditorit për pezullimin ose moskryerjen e një veprimi të caktuar për ekzekutimin e titullit ekzekutiv;
 - d) ____ % ose _____ lekë, kur titulli ekzekutiv në vlerën _____ ekzekutohet tërësisht dhe arkëtohet në llogarinë e kreditorit brenda afateve ligjore të treguara në Kodin e Procedurës Civile, por jo më shumë se **90 ditë** të pandërprera nga kërkesat e kreditorit për pezullimin ose moskryerjen e një veprimi të caktuar për ekzekutimin e titullit ekzekutiv;
 - e) ____ % ose _____ lekë, kur titulli ekzekutiv në vlerën _____ ekzekutohet tërësisht dhe arkëtohet në llogarinë e kreditorit brenda afateve ligjore të treguara në Kodin e Procedurës Civile, por jo më shumë se **60 ditë** të pandërprera nga kërkesat e kreditorit për pezullimin, moskryerjen e një veprimi të caktuar për ekzekutimin e titullit ekzekutiv.
3. Masa e tarifës së suksesit sipas këtij neni do të përfitohet proporcionalisht sipas nivelit të detyrimit të ekzekutuar dhe arkëtuar në llogarinë e kreditorit nga ana e zyrës përmbartimore, sipas përcaktimeve të njëjta kohore dhe vlerës së ekzekutuar të shumës së titullit ekzekutiv.

Opsioni 2

Neni 2

Tarifë suksesi sipas veprimeve përmbartimore të kryera

- Titulli ekzekutiv përmban një detyrim jomonetar dhe të pavlerësueshëm, dhe kreditori merr përsipër të paguajë vlerën e tarifës së suksesit të shërbimit përmbartimor në varësi të objektit të ekzekutimit, si më poshtë:
- a) _____ lekë për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, kur sendi i paluajtshëm ndodhet në vendin/qarkun/bashkinë ku kryen veprimtarinë përmbartuese gjyqësor;
 - b) _____ lekë për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, i cili shërben si ambient banimi për debitorin apo palët e lidhura me të dhe është funksional (me banorë) në momentin e kryerjes së ekzekutimit të detyrueshëm;
 - c) _____ lekë për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, i cili shërben si ambient biznesi, ambient rekreativ apo lokal, i cili është funksional në momentin e kryerjes së ekzekutimit të detyrueshëm;



ç) _____ lekë për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, i cili shërben si ambient banimi për debitorin apo palët e lidhura me të dhe është bosh në momentin e kryerjes së ekzekutimit të detyrueshëm;

d) _____ lekë për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, i cili shërben si ambient biznesi, ambient rekreativ apo lokal, i cili është bosh në momentin e kryerjes së ekzekutimit të detyrueshëm;

dh) _____ lekë për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, i cili është një fabrikë, magazinë, punishte ose ambient biznesi, ku gjenden linja prodhimi funksionale, të cilat së bashku me sendin e paluajtshëm, objekt ekzekutimi, kanë një vlerë të treguar në dokumentacionin e regjistruar, mbi 90 000 000 lekë;

e) _____ lekë për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, i cili është një truall, tokë bujqësore, arë me objekte dhe/ose sende të paluajtshme që nevojitet të shemben, prishen dhe/ose pastrohen nga objekti i ekzekutimit të detyruar nga përmbaruesi gjyqësor;

ë) _____ lekë për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, i cili është një truall, tokë bujqësore ose arë bosh;

f) _____ lekë për të gjitha rastet e treguara në këtë nen, kur koha e kryerjes së veprimit përmbarimor për lirimin dhe vënien në posedim të sendit të paluajtshëm kalon një sasi kohe prej 72 orësh punë jashtë orarit zyrtar dhe/ose përsëritjes së veprimit përmbarimor për lirimin dhe vënien në posedim të sendit të paluajtshëm më shumë se 1 herë për të njëjtin objekt.

Opsioni 3

Neni 2

Tarifa alternative e suksesit

1. Aplikimi i tarifës së kombinuar të suksesit mbi vlerën e detyrimit _____, e cila do të ekzekutohet nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror në formë të kombinuar, e treguar si metodë e ekzekutimit të detyruar sipas kësaj marrëveshjeje, do të përmbledhë një shumë përfitimi, e cila nuk do t'i kalojë _____ lekë dhe/ose _____ lekë. Përmbaruesi dokumenton, në procesverbalin që i bashkëlidhet kësaj marrëveshjeje, se kjo shumë nuk tejkalon shumën që do të rezultonte në secilën nga metodat e tjera të tarifimit.

2. Vlera e ekzekutimit të detyruar nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror, sipas metodës alternative të suksesit, referuar kësaj marrëveshjeje, do të tregohet dhe administrohet në një dokument të detajuar, që do të shërbejë si informacion dhe provë e suksesit të arritur nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror në ekzekutimin e titullit ekzekutiv sipas metodës alternative të suksesit.

Neni 3

Pagimi dhe llogaritja e tarifës së suksesit

1. Pala kreditore ka detyrimin që të informojë, brenda 10 ditësh nga momenti i realizimit të arkëtimit të detyrimit monetar të mbledhur për interes të saj, përmbaruesin gjyqësor shtetëror për shumat e ekzekutuara në llogari të saj. Tarifa e suksesit paguhet nëpërmjet derdhjes në llogarinë bankare të zyrës përmbarimore vendore që është pranë “(bankës) _____”, në numrin e llogarisë _____ dhe me numër IBAN: _____.

2. Pagesa sipas faturimit të tarifës së suksesit do të bëhet në llogarinë e zyrës përmbarimore vendore, jo më vonë se 5 ditë nga momenti i lëshimit të faturës dhe dërgimit të njoftimit të përmbaruesit gjyqësor shtetëror për tarifën e aplikuar mbi shumat e ekzekutuara.

3. Të gjitha tarifat e suksesit ngarkohen me TVSH, e cila llogaritet në momentin e faturimit dhe pagesës vetëm për atë pjesë të tarifës së suksesit, e cila faturohet dhe duhet të arkëtohet nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror, bazuar në kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë marrëveshje.



Kjo marrëveshje nënshkruhet rregullisht nga palët dhe bazuar në nenin 35, të ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”.

Kjo marrëveshje, pasi u lexua me zë të lartë dhe u kuptua, u nënshkrua rregullisht nga palët, si më poshtë:

KREDITORI

(emër, mbiemër, firmë)

ZYRA PËRMBARIMORE VENDORE _____
PËRMBARUESI GJYQËSOR SHTETËROR

(vula)

(emër, mbiemër, firmë)

Vendi dhe data e nënshkrimit: _____, _____.

KËRKESË

Nr. 13/12, datë 24.6.2024

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 749, datë 1.12.2022, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti ‘Ndërtimi i nënstacionit 400 kV Elbasan 3’”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit “arë” dhe “kulturat bujqësore”, bazuar në pikën 4, të nenit 17, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligjin nr. 3/2017, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin ‘Linja e transmisionit 400 kV Shqipëri–Maqedoni’”, ligjin nr. 4/2017, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2016, për projektin ‘Linja transmetimit 400 kV Shqipëri–Maqedoni

(zgjerim)”, si dhe ligjin nr. 101/2017, “Për ratifikimin e marrëveshjes se garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe KfW Frankfurt Am Main, në lidhje me marrëveshjen e huas ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST) dhe KfW Frankfurt Am Main, për projektin ‘Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri–Maqedoni (Fier–Elbasan–Qafë Thanë)’”, në bazë të të cilave është hartuar raporti i vlerësimit, të miratuar bazuar në planin e marrjes së tokës dhe kompensimit LACP (RAP), sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 34,672,074 (tridhjetë e katër milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë (nga të cilat 27,282,999 lekë i shtohen vlerës së miratuar me VKM-në nr. 749, datë 1.12.2022).

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 749, DATË 1.12.2022, PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI ‘NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 400 kV ELBASAN 3’”

Nr.	Pronëria (Emri Adresë Mbiemri)	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Sip. e pronës (m ²)	Sip. që shpronësohet (m ²)	Kompenzimi sipas VKM-së nr. 749, datë 1.12.2022 (vlera në lekë)		Kompenzimi sipas standardeve ndërkombëtare (vlera në lekë)		Kultura vjetore (m ²)		Kulturat shumëvjeçare (nr. pemësh)							Llogaritja vlerës së kompenzimit shesht (lekë)	Shënim
							Çmimi i tokës (lekë/m ²)	Vlera e shpronësimit të tokës	Çmimi i tokës (lekë/m ²)	Vlera e kompenzimit për tokën (lekë)	Jemshë	Muër	Ulliq 2-6 vite	Ulliq 11-20 vite	Ulliq 21-30 vite	Porcelan 2-4 vite	Shëgjë >5 vite	Arë 5-10 vite	Arë 11-30 vite	Shuma e kompenzimit për tërësinë (lekë)	
	a	b	c	d	e	f	g	h=g x g	i	j=i x i										k	l=j + i + k
1	Shet	2226	44/1/2	Atë	375	375		0	-	0											0
2	Fisat Asidik Zendi & Ali Begdosh Zendi	2226	44/1/3	Atë	2500	2500	222	555,000	589	1,472,300	2500									6,443	923,643
3	Mirdita Peci Medun	2226	44/1/4	Atë	2000	2000	222	444,000	589	1,176,000				42			9		4	1,202,470	1,906,470
4	Novi Vasil Bëra	2226	44/2	Atë	4000	4000	222	888,000	589	2,356,000		4000								41,200	1,809,200
5	Engjellina Josif Rana	2226	44/3/1	Atë	1,625	1,625	222	360,750	589	957,125											996,375
6	Kocani Josif Kioq	2226	44/3/2	Atë	1,625	1,625	222	360,750	589	957,125											996,375
7	Ndëqim Marthe Tullani	2226	44/4	Atë	3,792	3,792	222	841,824	589	2,233,488											1,991,664
8	Fik Tasi Zela Ferdin Dëbor Zela Ervin Jani Zela Mirat Jani Zela Aldina Vasil Sëllaku Dhimitër Vasil Zela Yongë Vasil Zela Jani Vasil Zela	2226	44/5	Atë	2,831	2,831	222	628,482	589	1,667,459		2,700								29,189	1,696,136
9	Dhimitër Vasil Zela Bekim Vironen Zela Kujtim Dhimitër Zela Dhimitër Dhimitër Zela	2226	44/6	Atë	2,700	2,700	222	599,400	589	1,590,300											990,900
10	Thoma B Bica	2226	45/2/1	Atë	2000	2000	222	643,800	589	1,708,000	2000									7,125	1,071,425
11	Shet	2226	45/2/2	Atë	100	100	222	22,200	-	0											0
12	Jorgji Tasi Bica	2226	45/3	Atë	2,750	2,750	222	610,500	589	1,619,750					110					3,116,011	4,125,261
13	Fos Rana	2226	45/4	Atë	3,200	3,200	222	915,200	589	1,884,800	3,200									7,863	976,913
14	Shet	2226	45/5	Atë	5,625	5,625	222	1,248,750	-	0											0
15	Shet	2226	45/6	Atë	1,675	1,675	222	371,750	-	0											0
16	Thoma Spas Roqi Aldina Gjergj Roqi Gentian Thoma Roqi Aldin Thoma Roqi Edhert Thoma Roqi Ervin Thoma Roqi	2226	45/7	Atë	3,539	3,539	222	785,658	589	2,084,471											1,298,413
17	Kostandë Simon Dënan	2226	45/8	Atë	5000	5000	222	1,110,000	589	2,945,000	2500	2500							1	46,588	1,881,818
18	Petar Gjergj Dënan	2226	45/9	Atë	2500	2500	222	555,000	589	1,472,300	2500									6,443	923,643
19	Lige Simon Dënan	2226	45/10	Atë	800	800	222	177,600	589	477,000	440									1,081	298,351
20	Agim Jakov Tullani	2226	45/11	Atë	2,715	2,715	222	602,700	589	1,599,135			125							1,299,026	2,855,431
21	Niko Vasil Bëra	2226	45/12	Atë	1,570	1,570	222	348,540	589	924,730											576,190
22	B.P. Aleks Vasil Bëra	2226	45/13	Atë	4,590	4,590	222	1,221,000	589	2,703,510		4590								47,277	1,529,787
23	Bekim Vasil Bëra	2226	45/14	Atë	2,375	2,375	222	527,250	589	1,398,875											871,625
24	Gentim Nuan Shati & Dukane Peter Shati	2226	45/15	Atë	1,625	1,625	222	360,750	589	957,125	1,625		31							36,251	922,096
25	Shet	2226	45/1/2	Atë	301	301	222	66,822	-	0											0
26	Edhert Josif Opa	2226	45/1/3	Atë	2000	2000	222	444,000	589	1,176,000											734,000
27	Edhert Josif Opa	2226	45/1/4	Atë	2,219	2,219	222	492,618	589	1,306,991											814,373
NET ELBASAN 3 - SHUMA E KOMPENIMIT SHITESH (lekë)							13,475,622	3,467,204												62,065,547	27,382,999

**KËRKESË****Nr. 206/8, datë 24.6.2024****PËR SHPRONËSIM DHE/OSE PËR
SHKËMBIMIN E PRONËS
PËR INTERES PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 719, datë 13.12.2023, ‘Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim, në Njësinë Administrative nr. 11, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Bashkia Tiranë”.

Subjekti kërkuar për këtë projekt është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim dhe/ose shkëmbim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur si:

1. Sipërfaqja e prekur e shpronësimit për pasurinë nr. 1/136, ZK 8320, në pronësi të Nysret Haki Haxhija dhe Sait Fani, sipas VKM-së **ishte 2336 m², bëhet 2335 m²**, dhe vlera **nga 53,692,960 lekë, bëhet 53,669,975 lekë** (me efekt zbritës për këtë pasuri).

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë Bashkisë Tiranë dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Kërkesa për ndryshimin e VKM-së nr. 719, datë 13.12.2023, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim, në Njësinë Administrative nr. 11, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Bashkia Tiranë” është me vlerë totale paraprake të kompensimit nga shpronësimi **53,669,975 lekë** (pesëdhjetë e tre milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë (me efekt zbritës për këtë pasuri).

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMIT DHE/OSE
SHKËMBIMIT
Kastriot Gurra



LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 719, DATË 13.12.2023, PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT, NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 11, UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS”,
BASHKIA TIRANË

Nr.	Pronari			Të dhënat (në pasuritë sipas ASHK-së)			Vlerësimet për shpronësim dhe/ose kompensim sipas llojit të pasurisë											Vlera në VKM-në nr. 719/2023 ishuc	Vlera totale (lekë) bëhet	Konfirmuar/shënime		
	Emri	Adresa	Mbicenti	ZK	Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip. totale truall/are m ²	Shpronësimi tokë "truall"			Sip. e ndërtesës totale (m ²)	Ndërtesë banimi (shëpi)			Ndërtesë jo banimi							
								Sip. e prekur (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)		Sip. e prekur (m ²)	Çmimi mesatar dh/derjeve sipas ASHK-së (lekë/m ²) për banesë	Vlera (lekë)	Sip. e prekur (m ²)	Çmimi sipas kostonit të ndërtimit nga EKB-ja (lekë/m ²) për jo banesë	Vlera (lekë)					
PRONË PRIVATE																						
1	Nymeri Shtet	Hala	Haship Fari	8320	1/136	Truall	2,335.0	2,335.0	22,985.0	53,669,975.00								53,692,060.00	53,669,975.00	Apkësimi 1330, datë 10.1.2024		
Totali pasurisë:								2,335.00														

Shënime:

1. Llogaritjet paraprahe të pasurive të kësaj liste, janë bazuar në materialin e dërguar të ASHK Tiranë Veri në përgjigje të aplikimit me nr. 1330, datë 10.1.2024.
2. Për vlerësimin e pasurive të llojit truall jemi referuar VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016.
3. Çmimi i miratuar me vendim nga Enti Kombëtar i Banesave bazohet në udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2016, të Këshillit të Ministrave, bashkëlidhur shkresës nr. 1644/1, datë 14.4.2021.

**NDREQJE GABIMI**

Në vendimin nr. 377, datë 12.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit’, të ndryshuar”, të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 102, datë 20.6.2024, f.10933, konstatohet gabim material, që duhet të ndreqet.

Konkretisht, në përmbajtje të nenit 6/2, të shtuar me nenin 6, të vendimit, në pikën 1, shprehja “... sipas pikave 2, 3, 4 dhe 5, të nenit 6/1, ...” zëvendësohet me “... sipas pikës 2, të nenit 6/1, ...” dhe në shkronjën “d”, të pikës 1, shprehja “...sipas pikës 3, të nenit 6/1, ...” zëvendësohet me “...sipas nënpikës 2.3, të nenit 6/1, ...” .

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 176 lekë